

1 E mërkurë, 24 mars 2021

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [Të akuzuarit marrin pjesë përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita dhe mirë se erdhët të
7 gjithë brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Zonja Sekretare e Gjykatës, ju lutem deklaroni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kjo
10 është lënda me numër KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar
11 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
12 Krasniqit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Sekretare.

14 Tani, u lutem palëve dhe pjesëmarrësve që të prezantohen,
15 duke filluar nga ZPS-ja.

16 Zonja Sekretare -- Zonja Prokurore.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar Gjykatës. Sot
18 përfaqësohet Prokuroria nga Jack Smith, Prokuror i Specializuar;
19 Alan Tieger, Prokuror i Lartë; David Harbach, prokuror; Artemis
20 Chatzistavrou, nëpunëse për nxjerrjen e provave; dhe unë jam Clare
21 Lawson, shefe e Zyrës Juridike.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

23 Tani i drejtohem avokatëve të mbrojtjes të prezantojnë ekipin
24 e tyre, duke filluar nga z. Hooper.

25 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëdita, i

1 nderuar Gjykatës. Pjesëmarrësit tanë për sot janë -- jam unë,

2 David Hooper, së bashku me Pierre Prosper. Faleminderit.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

4 Z. Emerson.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëdita, z.

6 Gjykatës. Jam Ben Emerson.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emerson.

8 Fjalën z. Young.

9 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë jam David
10 Young, përfaqësoj Rexhep Selimin.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Avokatja Alagendra.

12 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Mirëdita, i
13 nderuar Gjykatës. Unë jam Venkateswari Alagendra. Së bashku me
14 Aidan Ellis dhe Mentor Beqirin përfaqësojmë grupin e Mbrojtjes për
15 z. Krasniqi.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Për procesverbalin, dua të theksoj që z. Thaçi, z. Veseli, z.
18 Selimi dhe z. Krasniqi nuk ndodhen fizikisht të pranishëm në sallë
19 por e ndjekin këtë seancë përmes videokonferencës.

20 I drejtohem dhe Zyrës Administrative të prezantohet.
21 Sekretaria e Gjykatës.

22 Z. ROCHE: [Përkthim] Mirëdita, i nderuar z. Gjykatës. Ralph
23 Roche përfaqëson Divizionin e Shërbimeve Gjyqësore.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Për procesverbalin, unë jam Gjykatësi Nicolas Guillou.

1 Përpara se të fillojmë me rendin e ditës, u lutem palëve që
2 nëse kemi probleme me videolidhjen të ngrini dorën, dhe menjëherë
3 do të përpigemi që të marrim masat për ta rregulluar. Nëse lidhja
4 nuk rivendoset menjëherë, do ta ndërpresim për disa minuta seancën
5 derisa të rivendoset lidhja.

6 Më lejoni të kaloj tani me historikun procedural.

7 Më datë 17 mars të këtij viti kam nxjerrë vendimin për të
8 caktuar datën e kësaj konference. U kam kërkuar palëve që të japin
9 parashtime me shkrim për këto tema: Nxjerrjen e materialeve;
10 ecurinë e hetimeve të ZPS-së; ecurinë e hetimeve të Mbrojtjes;
11 pikat juridike dhe faktike për të cilat palët pajtohen; afati për
12 parashtimin e përgjigjeve ndaj mocioneve paraprake; data për
13 Konferencën e pestë për Ecurinë e Çështjes; dhe çdo çështje tjetër
14 të cilën palët dëshirojnë ta ngrenë.

15 Të hënën, më datë 22 mars, ZPS-ja dhe avokati mbrojtës i
16 Krasniqit kanë paraqitur vërejtjet e tyre me shkrim. I falënderoj
17 palët për këtë.

18 Qëllimi i konferencës sot është që të shikojmë se deri ku ka
19 ecur çështja dhe të diskutojmë temat që unë sapo i përmenda. Në
20 veçanti dëshiroj që të diskutojmë për çështjen e ngritur nga
21 Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit lidhur me nxjerrjen e
22 materialeve.

23 I ftoj palët që të paraqesin pikëpamjet e tyre në mënyrë
24 koncize për çdo pikë të rendit të ditës. Si zakonisht, i kujtoj
25 palët që të më njoftojnë paraprakisht nëse ndonjë parashtim

1 kërkon nxjerrjen e informacionit konfidencial, në mënyrë që të
2 kalojmë në seancë private apo të mbyllur.

3 I ftoj palët që të ndjekim rendin e ditës të parashikuar për
4 këtë Konferencë për Ecurinë e Çështjes, duke filluar me nxjerrjen
5 e materialeve.

6 Duke qenë se kemi disa çështje për të diskutuar lidhur me
7 nxjerrjen e materialeve, dëshiroj që diskutimin ta organizoj si
8 vijon:

9 Së pari, dëshiroj që të dëgjoj një përditësim të përgjithshëm
10 nga Prokuroria dhe nga ekipet e Mbrojtjes lidhur me ecurinë sa i
11 takon nxjerrjes së materialeve.

12 Së dyti, dëshiroj që të diskutoj në mënyrë të veçantë
13 kërkesat e avokatëve të Thaçit dhe Krasniqit për nxjerrjen e
14 urdhrave lidhur me nxjerrjen e materialeve dhe përgjigjet
15 përkatëse.

16 Së treti, dëshiroj që të diskutojmë për kërkesën e ZPS-së për
17 afatin për vënien në dispozicion të njoftimit të hollësishëm të
18 parashikuar nga rregulla 102(3), afat ky që është caktuar përpara
19 po që kërkohet të ndryshohet.

20 Për ta fokusuar diskutimin për këto pika, dëshiroj që palët
21 t'i thonë parashtimet e tyre për këto tre tema në momentin e
22 duhur.

23 Fillimisht, dëshiroj që të dëgjoj pikëpamjen e Prokurorisë,
24 fjalën e Prokurorisë lidhur me ecurinë e nxjerrjes së materialit
25 provues në përgjithësi, sidomos, në veçanti, sa i takon materialit

1 të parashikuar nga rregulla 102(1)(b), edhe sa material i tillë
2 mbetet për t'u nxjerrë, dhe dua të di nëse ZPS-ja parashikon
3 parashtrimin e kërkesave për masa mbrojtëse brenda datës 6 prill
4 2021.

5 Dëshiroj që ZPS-ja të informojë Gjykatën për sa vijon: Nëse
6 mbeten prova shfajësuese në ruajtje, kontroll, apo në dijeni të
7 ZPS-së, dhe nëse një material i tillë kërkon një vendim paraprak
8 për masa mbrojtëse.

9 Dhe, nëse ZPS-ja përballet apo parashikon të përballet me
10 ndonjë vështirësi sa i takon procesit të nxjerrjes së materialeve,
11 sidomos sa i takon materialeve të rregullës 107, dhe nëse do të
12 bëjë ndonjë kërkesë, do të parashtrojë ndonjë kërkesë lidhur me
13 këtë.

14 Zonja Prokurore, keni fjalën.

15 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

16 Sa i takon përditësimit të nxjerrjes së materialeve në
17 përgjithësi, pas konferencës së fundit Prokuroria ka nxjerrë edhe
18 dy paketa me materiale sipas rregullës 102(1)(b); janë paketat 23
19 dhe 24. Po vijojmë që të punojmë, pra, të shikojmë me imtësi
20 materialet e tjera në mënyrë sistematike. Kemi depozituar një
21 kërkesë të katërt për masa mbrojtëse lidhur me materiale të tilla
22 më datë 5 mars, dhe parashikojmë në të vërtetë që të parashtrojmë
23 dhe kërkesa të tilla të tjera në përputhje me grafikun kohor të
24 parashikuar nga Gjykatësi -- të vendosur nga Gjykatësi, pra, ose
25 më datë 6 prill, ose para datës 6 prill.

1 Po bëjmë përshtatjet përkatëse lidhur me nënkategorizimin
2 shtesë në përputhje me vendimin e Dhomës së -- e Gjykatës pra, për
3 rregullën 109(c).

4 Sa i takon vëllimit, deklaratat e mëparshme të afërsisht të
5 një të dytës së dëshmitarëve në mbështetje të aktakuzës janë
6 përpunuar tashmë dhe ato janë vënë në dispozicion, pra, janë
7 nxjerrë dhe janë pjesë e kërkesës që kemi depozituar për masa
8 mbrojtëse për të cilat ende nuk është marrë vendim.

9 Sa i takon materialit shfajësues, po bëhet shqyrtimi, pra,
10 është në -- nuk ka përfunduar shqyrtimi. Nuk parashikohen që të
11 bëhen së afërmi kërkesa për masa mbrojtëse lidhur me një material
12 të tillë, por ne do të bëjmë -- kur të bëjmë nxjerrje të mëtejshme
13 të materialeve mund të bëjmë edhe kërkesa të tilla kur të vijë
14 momenti i duhur në lidhje me këtë material.

15 Sa i takon materialit të rregullës 107, situata mbetet e
16 njëjtë siç kemi thënë më përpara, lidhur me një organizatë. Me të
17 përfunduar diskutimet për masat kundërbalancuese të mundshme, ne
18 parashikojmë që të bëjmë një kërkesë, parashikojmë që do të ketë
19 pra, kërkesa të tilla në lidhje me organizatat e tjera.

20 Kaq kishim.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

22 Tani i kthehem Mbrojtjes. Pra, edhe njëherë ju rikujtoj që hë
23 për hë do të flasim vetëm për çështjet e përgjithshme të nxjerrjes
24 së materialeve. Pas këtij raundi të parë do t'u kthehemi çështjeve
25 të veçanta që ka ngritur Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit.

1 Z. Hooper.

2 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

3 Do t'u kthehem çështjeve kur të flasim në mënyrë të veçantë
4 për to, nëse mundem pak më vonë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

6 Z. Emerson.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë
8 për të shtuar në këtë moment. Faleminderit.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Young, ju lutem.

11 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, s'kam asgjë.
12 Faleminderit.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti avokat.

14 Znj. Alagendra.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë s'kemi
16 në këtë fazë, i nderuar Gjykatës.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Alagendra.

18 Dëshiroj tani që të diskutojmë për kërkesën e Thaçit dhe
19 Krasniqit për lëshimin e urdhrave lidhur me nxjerrjen e
20 materialit. Është parashtrimi i protokolluar me numër F213 dhe
21 F228. Unë do t'i marr masat me radhë siç janë kërkuar.

22 Së pari, për nxjerrjen e materialit për të cilët -- për të
23 cilin i akuzuari ose dëshmitari përmendet në një intervistë;

24 Së dyti, numrin ERN të çdo prove materiale të përmendur në
25 një intervistë të një akuzuari apo dëshmitari; dhe

1 Së treti, nxjerrjen e regjistrimeve audiovizive të
2 intervistave të një dëshmitari apo të një të akuzuari;

3 Së katërti, numrat e dëshmitarëve për materialet përkatëse.

4 Pra, në fillim kërkohet nga Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit
5 lëshimi i një urdhri që ZPS-ja t'i nxjerrë të gjitha materialet
6 dhe dokumentet e përmendura në një intervistë. Mbrojtja kërkon që
7 ZPS-ja të nxjerrë të gjitha materialet dhe dokumentet e përmendura
8 në një intervistë të një të akuzuari apo dëshmitari.

9 E kuptoj nga përgjigjja e ZPS-së se tani i ka nxjerrë provat
10 materiale të përdorura në intervistat e z. Thaçi. Mirëpo, unë
11 gjithashtu informohem nga përgjigjja e avokatit mbrojtës të Thaçit
12 se deri tani ZPS-ja -- se deri tani kjo Mbrojtje nuk i ka marrë
13 provat materiale që i janë treguar tre të bashkakuzuarve në
14 intervistat e tyre përkatëse, pra, tre të akuzuarve të tjerë.
15 Dëshiroj që t'u kërkoj palëve që të më informojnë se çfarë ka
16 ndodhur më tej lidhur me këtë çështje, dhe nëse do të bëhet një
17 gjë e tillë brenda Konferencës së ardhshme për Ecurinë e Çështjes.

18 Zonja Prokurore, fjala për ju.

19 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dëshiroj që të
20 them dy gjëra të përgjithshme për këtë pikë përpara se të kalojmë
21 te masa e parë e cila kërkohet. Janë pika procedurale, megjithatë
22 janë të rëndësishme në këtë kuadër.

23 E para është se çështjet e ngritura në këtë kërkesë, në këtë
24 ankesë pra, janë ato të cilat ekipi i Mbrojtjes ka vendosur mos
25 t'ia sjellë në dijeni ZPS-së në mënyrë *inter partes*, pra, në

1 diskutimet dypalëshe në mes tyre. Pjesa më e madhe e këtyre
2 çështjeve mund të ishte zgjidhur në mënyrë shumë më efikase nëse
3 avokatët e Mbrojtjes do ta kishin kontaktuar direkt Prokurorinë.

4 Gjëja e dytë që desha që të ngre ka të bëjë me përgjigjen e
5 Mbrojtjes së Thaçit. Ky parashtim shkon përtej përgjigjeve të
6 autorizuara dhe përbën një shkelje të mekanizmit të rregullës 76,
7 prandaj duhet rrëzuar në përputhje me këtë. Në vend që të trajtojë
8 çështje të reja, parashtimi përsërit të njëjtin informacion, ose
9 orvatet që të mbështesë në mënyrë të pakuptimtë parashtimet e
10 mëparshme.

11 Tani do t'i kthehem masës së parë për të cilën -- kërkohet
12 nga Mbrojtja. Do të ishte ideale, sigurisht, që të kishim një
13 paketë të plotë të dëshmitarëve sa më shpejt. Kjo është pa -- kjo
14 nuk kërkon diskutim. ZPS-ja është në proces të vënies në
15 dispozicion, pikërisht, të materialeve të cilat janë, kërkojnë --
16 janë objekt i kësaj kërkesë, dhe ne këtë po e bëjmë me shpejtësinë
17 dhe efikasitetin që na lejojnë rrethanat. Me përjashtim të dy
18 dokumenteve, të gjitha shembujt e përmendur në parashtimet e
19 Mbrojtjes lidhur me paketa të paplota të dëshmitarëve, janë
20 intervista të cilat janë vendosur në dispozicion si pjesë e
21 materialit mbështetës së aktakuzës.

22 Pas Paraqitjes së Parë dhe në përputhje me rregulloren, ZPS-
23 ja menjëherë ka vendosur në dispozicion materialin mbështetës të
24 aktakuzës. Asnjëherë nuk është sugjeruar që materiali mbështetës i
25 aktakuzës përfshinte dhe paketat e dëshmitarëve. I gjithë qëllimi

1 i procesit të mëpasshëm të nxjerrjes së materialeve gjatë
2 Procedurë Paraprake është që të plotësohen këto me materiale të
3 tjera shtesë, në të cilat ne do të mbështetemi në kazusin tonë.

4 Aktualisht jemi duke punuar me deklaratat paraprake të
5 dëshmitarëve, dhe në momentin e duhur do të kalojmë edhe te provat
6 materiale të lidhura me dëshmitarë të tjerë. ZPS-ja nuk ka
7 refuzuar kurrë që t'i vendosë në dispozicion këto materiale, dhe
8 karakterizimi i Mbrojtjes së Thaçit është një prej parashtrimeve
9 të tjera keqorientuese që ata kanë bërë në parashtrimet e tyre të
10 fundit. Përkundrazi, ne jemi duke vendosur në dispozicion
11 materialet me shpejtësinë dhe efikasitetin që mbetet.

12 Për të qenë më konkret lidhur me atë çka na kërkohet,
13 shembujt që jepen në shtojcën e parashtrimit të Mbrojtjes së
14 Thaçit kanë të bëjnë me 19 dëshmitarë. Nga këto -- pretendohet
15 pra, se mungojnë deklaratat paraprake. Për shembull, po të
16 shikojmë vetëm faqen e parë të shtojcës së Thaçit, pika e parë, e
17 dytë, e gjashtë, e shtatë, e tetë që jepen aty, kanë të bëjnë të
18 gjitha me deklarata paraprake të dëshmitarëve. Po kështu në mënyrë
19 të ngjashme, nga faqja 1 deri në faqen 3 të shtojcës së Mbrojtjes
20 së Krasniqit, ne identifikojmë edhe materiale të cilat pretendohen
21 që kanë të bëjnë me -- se mungojnë pra, por janë materiale të
22 lidhura me dëshmitarët. Nga tetë dëshmitarët e identifikuar, për
23 gjashtë të identifikuar -- për gjashtë prej tyre është përsëri --
24 pra, përsëri bëhet fjalë për deklarata paraprake të cilat sërish
25 na kërkohen tani.

1 E njëjta gjë edhe sa i takon Konferencës së fundit për
2 Ecurinë e Çështjes, ne e kemi bërë këtë gjë, pra, në kuadër
3 pikërisht të kësaj.

4 Sa i takon provave të tjera materiale, në përputhje me atë që
5 është bërë në mënyrë *inter partes*, të gjitha provat materiale që
6 lidhen me intervistat e z. Thaçi janë nxjerrë. Më saktë, nga 54
7 prova materiale gjithsej, vetëm gjashtë kanë mbetur pa u nxjerrë,
8 kishin mbetur më saktë, pa u nxjerrë përpara se të bënte
9 parashtrimin e vet dhe kërkesën e saj Mbrojtja. Pritet që këto
10 prova që lidhen me intervistat e ZPS-së me të akuzuarit e tjerë do
11 të vendosen në dispozicion shumë shpejt. Në fakt, ose këtë javë,
12 nëse jo, atëherë në fillim të javës tjetër.

13 Unë mendoj se nga ana e Mbrojtjes nuk po vlerësohet dhe nuk
14 kuptohet fare puna e madhe që na kërkohet për përpunimin e
15 materialeve. Ne për shembull, kontrollojmë statusin e përkthimit,
16 shikojmë redaktimet e fazave të ndryshme, bëjmë një shqyrtim për
17 këto, sa i takon redaktimeve standarde ashtu dhe jostandarde, të
18 cilat shpesh bëhen në versione të ndryshme gjyqësore. Pastaj është
19 kategorizimi dhe përshkrimi me etiketim i dokumenteve për qëllime
20 të tjera të nxjerrjes së materialeve, si edhe një kontroll i
21 fundit i rregullës 107.

22 Këto hapa nuk mund të anashkalohen, nuk mund të eliminohen.
23 Kërkojnë shumë kohë. Dhe kjo ndërkohë kur pjesa më e madhe e
24 stafit tonë vijon të punojë pa qenë në zyrë, pa pasur mundësi
25 hyrje në softuerët dhe në databazat e centralizuara. Sigurisht kjo

1 përbën një barrë shumë të madhe logjistike në çdo fazë të
2 procesit.

3 Pavarësisht nga kjo, ne po vijojmë që të nxjerrim materiale
4 të mënyrë të rregullt në përputhje me afatet e vendosura, dhe
5 madje edhe shumë kohë para afateve kur na jepet mundësia. Mbrojtja
6 do të marrë materialet e mbetura të dëshmitarëve në momentin më të
7 hershëm të mundshëm që do t'i jepet mundësia ZPS-së.

8 Të ndaloj këtu dhe pastaj të flasim për pikën tjetër?
9 Faleminderit.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

11 Z. Hooper.

12 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit.

13 Falënderoj edhe Prokuroren.

14 Së pari, ta bëj të qartë që në fillim se në masën që është e
15 mundur unë e kuptoj që ka vështirësi logjistike për sa i përket
16 paraqitjes së provave në një sistem gjykate elektronik, dhe
17 sigurisht ka vështirësi të cilat e bëjnë edhe më të vështirë punën
18 si për Prokurorinë ashtu dhe për të tjerët. Ka dhe vështirësi dhe
19 kufizime të tjera të cilat -- nën të cilat po punojmë të gjithë.

20 Në një atmosfere jobashkëpunuese, gjithmonë jo -- më
21 jobashkëpunuese, mund të ketë njëfarë moskuptimi nga njëra palë e
22 pozicionit të palës tjetër. Megjithatë, ne kërkojmë një sistem të
23 nxjerrjes së materialeve përmes të cilit Prokuroria t'i japë
24 Mbrojtjes materiale të cilat ata mund t'i vlerësojnë. Dhe, unë
25 mendoj që në thelb të kësaj është ajo që ne tani po punojmë me një

1 sistem nxjerrje të materialeve që është i copëzuar dhe jo i
2 dobishëm. Dhe unë mendoj, i nderuar Gjykatës, që Mbrojtja e ka
3 ngritur vazhdimisht këtë shqetësim.

4 Në qoftë se kemi një sistem të nxjerrjes së provave që është
5 sistem për nxjerrjen e materialeve në vijimësi, brenda parametrave
6 kohore që tani shtrihen jo thjesht deri në maj, po edhe deri në
7 korrik, dhe mbas kësaj ekziston edhe urgjenca që po dikton
8 Prokuroria për të bërë -- për të filluar gjykimin sa më shpejt, të
9 cilin ne e kundërshtojmë për të gjitha arsyet e mira dhe praktike
10 që i kemi paraqitur më parë.

11 Por, në qoftë se do të bëhet nxjerrja e materialeve në
12 vijimësi, dhe i quaj fazat A, B, C, D, E, për dëshmitarët A, B, C,
13 D, dhe E. Ne tani marrim vetëm pjesë të dëshmive të tyre, ose të
14 provave që lidhen me ta. Dhe çfarë vlere ka kjo për Mbrojtjen?

15 Në përgjigje të parashtimit që bëjmë ne, Prokuroria tha që
16 "oh, po ne -- Mbrojtja po e ekzagjeron." Por realiteti është që të
17 gjitha këto aspekte janë të lidhura me njëra-tjetrën.

18 Në qoftë se do të kemi nxjerrje të materialeve, kjo duhet të
19 bëhet në mënyrë më praktike që të na japë ne si Mbrojtje materiale
20 të vlerësueshme, dhe kjo të bëhet dëshmitar pas dëshmitari. Mos na
21 jep A, B, C, D, E, në një mënyrë rastësore. Na jep komplet
22 dëshmitarin A, paketën e dëshmitarit A, intervistën dhe çdo
23 dokument tjetër që lidhet me atë dëshmitar. Dhe ne në këtë mënyrë
24 mund ta shqyrtojmë atë dëshmitar, dhe mos t'i kthehemi përsëri
25 atij dëshmitari se çfarë mund të ketë thënë në një kontekst

1 tjetër.

2 Pra, e shikoj që Prokuroria ka ngritur çështjen që kur ju, i
3 nderuar Gjykatës, konfirmuat aktakuzën, nuk kishte nevojë që ju
4 t'i lexonit të gjitha provat. Por ju, i nderuar Gjykatës, keni një
5 detyrë krejt tjetër nga e jona.

6 Unë e thashë që në fillim që unë do të flas për çështje të
7 përgjithshme në fillim, dhe dua të flas shkurt. Dhe mënyra sesi
8 jam përgatitur për këto çështje me ndihmën e Sophie Menegon, e
9 cila është e ashtuquajtura portiere e jona, ajo i merr të gjitha
10 materialet dhe i kontrollon se për çfarë janë. Por ajo nuk mund të
11 jetë sot këtu sepse lindi një bebe para disa ditësh, dhe e uroj
12 për këtë, i jap përgëzimet e mia.

13 Por tani t'i kthehem përsëri problemit tonë, çështjeve që u
14 ngritën, sepse kjo ka filluar më përpara këtyre parashtimeve të
15 protokolluara që janë bërë kohët e fundit. Çështja që u ngrit në
16 Konferencën e tretë për Ecurinë e Çështjes për parashtimin e
17 protokolluar me numër F123. Disa nga çështjet, për shembull,
18 tabela, janë trajtuar nga ju, i nderur Gjykatës.

19 Po para sesa të kaloj te çështja e nxjerrjes së materialeve,
20 të prek disa çështje që i përmendi znj. Menegon herën e kaluar, po
21 ju nuk keni dhënë vendim akoma për to, i nderuar Gjykatës.

22 Ne sugjeruam që të kemi një listë paraprake të dëshmitarëve.
23 Prokuroria duhet të ketë një ide se cilët dëshmitarë do të
24 thërrasë të japin dëshmi. Dhe një listë -- kjo listë ne e kuptojmë
25 që do të jetë listë e përkohshme.

1 E dyta, lidhja e dokumenteve me dëshmitarët në sistemin Legal
2 Workflow, sistemin elektronik. Janë nja 3.000 dokumente, dhe disa
3 prej tyre nuk kanë një numër që t'i jetë caktuar. Prokuroria thotë
4 që disa prej tyre -- për disa prej tyre kjo është për shkak se ato
5 i nënshtrohen redaktimeve. Po unë s'e kuptoj sesi mund të japin
6 këtë shpjegim, sepse lidhja e një dokumenti me një numër nuk
7 zbulon ndonjë gjë.

8 Megjithatë, ekziston nevoja që të ecim paralelisht, që të
9 bëhet -- të jemi në një hap me njëri-tjetrin, sepse në nxjerrjet
10 që ka bërë Prokuroria në fazat e mëparshme nuk na i ka dhënë këto
11 informacione, nuk i ka lidhur dëshmitarët me dokumentet. Prandaj
12 dhe kërkojmë që Prokuroria të riparagesë këto dokumente dhe t'i
13 lidhë me dëshmitarët përkatës.

14 Ju, i nderuar Gjykatës, dhe kolegët e mi keni një kopje të
15 mocionit tonë për çështje të nxjerrjes, ku kemi kërkuar nxjerrje
16 të materialit dhe masat përkatëse.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper, a mund t'ju
18 ndërpres? Së pari, të flasim për masën ndreqëse që keni kërkuar
19 për pikën e parë. Ju e ngritët këtë në Konferencën e tretë për
20 Ecurinë e Çështjes në lidhje me urdhrin, se çfarë urdhri kërkon, po
21 këtë do ta bëjmë në një diskutim tjetër.

22 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Sigurisht, unë jam
23 në dorën tuaj, i nderuar Gjykatës, për t'i diskutuar këto çështje.
24 Megjithatë, mendova se në lidhje me masën ndreqëse që kërkoj, unë
25 do ta trajtoja këtë në rend të kundërt sepse do të na shkurtojë

1 shumë punë dhe shumë diskutime.

2 Për shembull, kërkesa e katërt në urdhrin që keni parë ju, i
3 nderuar Gjykatës, ishte që -- ajo që kërkonim ne ishte që ZPS-ja
4 të jepte numrat e dëshmitarëve për të gjitha materialet, dhe atë
5 po e bëjnë tani. Dhe në lidhje me këtë desha t'ju shpjegoj, i
6 nderuar Gjykatës, që ne po punojmë duke shkuar pak mbrapa në
7 lidhje me këtë.

8 Për sa i përket të gjitha incizimeve audiovizuale që kemi
9 bërë dhe -- d.m.th., kërkesave për regjistrimet audiovizuale,
10 sigurisht, Mbrojtja ka të drejtë t'i shikojë ato. Dhe kjo nuk
11 është -- është urgjente, po edhe çështja e redaktimeve është një
12 çështje urgjente, por jo dhe aq, nuk është prioritet.

13 Në lidhje me masën ndreqëse të dytë që kam kërkuar, kjo është
14 që ju, i nderuar Gjykatës, t'i jepni urdhër Prokurorisë që të japë
15 të gjithë numrat e referencës së provës, pra, numrat ERN, për të
16 gjitha provat materiale që përmenden në një intervistë të bërë nga
17 një dëshmitar. Unë e kuptoj se një prej problemeve këtu është që
18 numrat ERN -- është se disa dokumente janë në forma apo formate të
19 ndryshme. Pra, i njëjti dokument paraqitet në formate të ndryshme,
20 ose në të njëjtin format po në vende të ndryshme me numra të
21 ndryshëm ERN-je. Pra, kur Prokuroria u përpoq të lidhte një
22 dokument përmes numrit ERN, kjo nuk na jep domosdoshmërisht numrin
23 ERN që presim ne, dhe ne nuk e gjejmë atë. Kjo me sa duket është
24 një vështirësi teknike që lind për shkak të përsëritjes së
25 dokumenteve.

1 Ne sugjerojmë që - ekziston ky numër 3.000 dokumente - dhe
2 Prokuroria të na japë, siç i dhanë z. Thaçi kohët e fundit, të na
3 japë pra, një tabelë me numrat ERN që lidhen me secilin dëshmitar.
4 Nuk mendoj që kjo është e vështirë. Ata me siguri që e kanë sepse
5 është pjesë e sistemit të tyre. Dhe në qoftë se e bëjmë këtë,
6 atëherë e kapërcejmë këtë problem.

7 Më duket sikur u ktheva pak mbrapsht në ato gjërat që po
8 diskutonim, po shpresoj që ju, i nderuar Gjykatës, e shikoni sepse
9 e bëra këtë. Janë çështje që janë ngritur përmes parashtimeve që
10 janë bërë dhe janë diskutuar dhe mund të zgjidhen lehtë.

11 Unë e vura re në përgjigjen paksa të ashpër të z. Smith që
12 Mbrojtjes duhet t'i bëhet një paralajmërim, sepse ne nuk jemi
13 përpjekur që t'i zgjidhim çështjet midis palëve. Mua kjo nuk më
14 duket një vërejtje kolegjiale.

15 Unë di, kam njohuri për sisteme të ndryshme me avokatë nga
16 juridiksione të ndryshme të cilët diskutojnë me oponentët e tyre,
17 por mënyra e shprehjes së tij nuk është e përshtatshme.

18 Gjithashtu ai na akuzon ne, Mbrojtjen e Thaçit, për
19 teatralitet, dhe që ne këtu duam të ngremë probleme në lidhje me
20 nxjerrjen. Unë nuk jam person që bëj gjeste teatrale. Unë nuk jam
21 ai lloj avokati. Mocioni ynë ka dalë nga fakti që ne nuk jemi të
22 kënaqur me mënyrën sesi po bëhet nxjerrja e materialeve, që është
23 bërë në mënyrë rastësore, e copëzuar dhe diktohet vetëm nga ajo që
24 do të bëjë Prokuroria, dhe jo nga ajo që është e pranueshme dhe e
25 përpunueshme nga Mbrojtja. Dhe ata mbrohen nga vendimi juaj i

1 nderuar Gjykatës dhe thonë që "ju kërkoni, ne ju japim, dhe në
2 fund ju do t'i keni të gjitha në rendin e duhur, në fund të majit
3 apo në fund të korrikut kur është afati." Dhe ne themi që "kjo nuk
4 është mënyra e duhur e nxjerrjes së materialeve." Siç e thashë dhe
5 e shpjegova arsyen pse që në fillim të parashtimit tim.

6 Unë nuk mendoj se kam nevojë të them më shumë në lidhje me
7 këtë çështje. Ju, i nderuar Gjykatës, keni edhe parashtimin tonë
8 dhe përgjigjen që i kemi dhënë Prokurorisë. Unë nuk jam dakord me
9 atë që tha znj. Lawson, sepse ne faktikisht i jemi përgjigjur në
10 mënyrë të duhur të gjitha çështjeve në mënyrë që t'ju ndihmojë
11 juve, i nderuar Gjykatës.

12 Ne nuk po përpiqemi të kundërshtojmë për hir të
13 kundërshtimit. Ne po kundërshtojmë dhe po ju themi se ne kemi
14 vështirësi dhe vështirësia kryesore që del është kërkesa jonë në
15 lidhje me pikën e parë për masat ndreqëse, që Prokuroria të japë
16 të gjitha dokumentet që lidhen me një të akuzuar ose me një
17 dëshmitar në intervistën që ka dhënë ky person, në të njëjtën kohë
18 që jepet edhe deklarata apo intervista.

19 Dhe jo vetëm kjo, kjo praktikë nuk është ndjekur deri tani,
20 por ne kërkojmë që të bëhet në të ardhmen në lidhje me të gjitha
21 materialet për të cilat ka bërë komente secili prej të akuzuarve,
22 dhe këto të jepen brenda 14 ditëve, dhe ato komente apo materiale
23 të tjera që lidhen me dëshmitarin, brenda 28 ditëve nga koha që
24 ju, i nderuar Gjykatës, keni miratuar aktakuzën.

25 Dhe Prokuroria thotë: "Ne nuk keni sepse të na qortoni, sepse

1 nuk kemi diskutuar këto çështje *inter partes*, ndërmjet njëri-
2 tjetrit." Po ne vazhdimisht kemi diskutuar me njëri-tjetrin.

3 Dhe ne në rastin e z. Thaçi jemi një shembull i mirë i kësaj.
4 Z. Thaçi si klienti ynë, ai ka bërë intervistë, është marrë në
5 pyetje, dhe na kanë treguar për të një numër materialesh që janë
6 60 apo 70 faqe [sipas përkthimit] të intervistës. Atij i kanë
7 treguar gjatë asaj kohe prova të ndryshme materiale dhe të shumta
8 materiale. Ne kërkuam nga Prokuroria që të na i japë këto. Ata na
9 kanë thënë që e kanë prioritetizuar këtë kërkesë, por ata nuk na e
10 kanë dorëzuar derisa ne dorëzuam mocionin. Kur ishte, më 17 apo më
11 18 mars, para disa ditësh.

12 Pra, ende nuk i kemi marrë, siç ju thashë, edhe materialet që
13 u janë treguar të akuzuarve të tjerë. Dhe ajo që është e çuditshme
14 këtu edhe që ne e kemi theksuar në përgjigjen tonë, është se
15 ambasadori Prosper, i cili ishte mbrojtësi i pranishëm përmes
16 lidhjes me audio dhe video sepse ai ishte faktikisht në Shtetet e
17 Bashkuara, dhe President Thaçi - në atë kohë ishte President - ai
18 erdhi këtu në Hagë për t'u marrë në pyetje, ata, pra, Prokuroria i
19 dha Mbrojtjes, i dha ambasadorit Prosper një tufë materialesh të
20 cilat do të diskutoheshin në intervistën e korrikut me zotimin që
21 ai nuk do t'i kopjonte ato, apo t'i skanonte, apo t'i kopjonte në
22 çfarëdo mënyre, dhe të mos mbante asnjë kopje të tyre. Dhe ai iu
23 përmbajt këtij zotimi.

24 Pra, është e qartë që në fund të korrikut të vitit të kaluar,
25 Prokuroria e kishte një tufë dokumentesh që mund t'i dorëzonin,

1 pra, të materialeve që do t'ia tregonit z. Thaçi. Dhe është e
2 qartë kjo. Pra, atëherë, kur na dhanë intervistën, pse s'na e
3 dhanë edhe atë tufë dokumentesh? Dhe unë nuk arrij ta kuptoj pse
4 jo? Nuk ka të bëjë pra, kjo me KOVIDIN apo me arsye teknike. Në
5 këtë rast ata po e shikojnë teleskopin së prapthi.

6 Ne ju drejtuam juve, i nderuar Gjykatës, pas një muaji sepse
7 ende s'i kishim marrë këto materiale. Dhe unë kisha ardhur në Hagë
8 për të takuar z. Thaçi, dhe kur pyeta që -- edhe pas tri javësh
9 mbasi kisha ardhur unë në Hagë pyeta për këto prova materiale, ato
10 nuk ishin, nuk na i kishin dhënë. Dhe prandaj ju drejtuam juve, i
11 nderuar Gjykatës, për ta zgjidhur këtë, sepse në qoftë se nuk ju
12 drejtohem i ju, i nderuar Gjykatës, atëherë ne mund të sillemi
13 rrotull pa asnjë lloj rezultati.

14 Pra, kaq kisha për të thënë në lidhje me çështjen e nxjerrjes
15 së materialeve. Nuk e di nëse fola shumë gjatë, ju kërkoj ndjesë
16 për këtë, sepse është e vështirë faktikisht të flasësh shkurt në
17 lidhje me këto çështje. Megjithatë, besoj që të -- këto gjëra i
18 kam diskutuar në mënyrën dhe në rendin e duhur.

19 E theksoj dhe njëherë që unë këtu nuk po bëj gjeste teatrale
20 dhe nuk po përpiqem të bëj akuza false ndaj Prokurorisë. Dhe
21 parashtimi ynë, dhe e di që kolegët e mi pajtohen me këtë, kjo
22 lind nga moskënaqësia -- nga pakënaqësia që Prokuroria nuk po i
23 trajton çështjet për të -- të cilat ua kemi kërkuar ne.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper. Besoj
25 që do të jeni pak më i shkurtër në raundet e tjera të diskutimit,

1 megjithatë, juve ngritët çështje shumë të rëndësishme.

2 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar
3 Gjykatës, pak a shumë kjo është gjithçka që unë kam për të thënë
4 në fakt. Për çështjet e tjera do të flas shumë shkurt. Por
5 sigurisht që është z. Emerson që do të ketë dhe ai fjalën e tij
6 për të thënë, por ju kërkoj ndjesë që ju mora kaq kohë herën e
7 parë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, dhe transmetoji
9 urimet e mia znj. Menegon.

10 Faleminderit, z. Hooper.

11 Z. Emerson, fjala për ju.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk e di në
13 qoftë se mund t'i përmbahemi kërkesës së parë për masa ndreqëse që
14 parashtrohet në kërkesën e z. Thaçi. Kam shumë pak për të thënë në
15 fakt lidhur me këtë çështje, dhe nuk kam asgjë për të shtuar
16 lidhur me atë çfarë u tha nga personi që foli përpara meje.

17 Pra, në këtë fazë më lejoni të them që pretendimi i z. Smith
18 që Mbrojta e z. Thaçi po kërkon që të krijojë një themel provash,
19 ose me fjalë të tjera, të krijojë njëlloj historiku të
20 vështirësive që kanë të bëjnë me nxjerrjen e informacionit, është
21 një pretendim në keqbesim. Dhe në fakt kjo nuk është hera e parë
22 që Prokuroria ka shkuar në një pozicion që ka të bëjë me
23 komentimin e punës së Mbrojtjes. Dhe në fakt Mbrojtja nuk ka bërë
24 gjë tjetër veçse ka reaguuar në përputhje me ligjin.

25 Dhe kjo është theksuar dhe herë të tjera, edhe në kërkesa të

1 tjera ndreqëse, ku thuhet që Mbrojtja e ka kohën e nevojshme për
2 t'u përgatitur për çështjen, ndërkohë që koha plus që kërkohet nga
3 Mbrojtja, thjesht po përdoret si arsye nga Mbrojtja, edhe që nuk
4 ka -- nuk është progresionale si kërkesë. Në fakt kjo është një
5 kërkesë e jashtëzakonshme e cila parashtrohet nga Prokuroria
6 ndërkohë që ju, i nderuar Gjykatës, e dini që kërkesat për masa
7 ndreqëse janë refuzuar. Dhe, siç dëgjuam sot më përpara,
8 Prokuroria po kërkon shtim kohe, kohë më tepër në mënyrë që të
9 mund të ofrojë detyrimet e saj.

10 Pra, dua të them që idetë që sjellja e duhur e Mbrojtjes
11 duhet të karakterizohet si njëlloj pengese e punës së Prokurorisë,
12 apo e Tribunalit, e Gjykatës, ka një reflektim shumë të keq jo
13 vetëm për Prokurorinë, por jep imazh të keq edhe për vetë
14 Gjykatën. Kështu që do t'i kërkoja z. Smith që të hiqte dorë nga
15 bërja e akuzave të tilla në drejtim të Mbrojtjes. Pra, e kam
16 fjalën këtu për aplikimin dhe kërkesën e fundit të Mbrojtjes së z.
17 Thaçi, por e kam fjalën gjithashtu edhe në kuadrin më të gjerë.

18 Pra, thjesht doja që të thosha për procesverbal që këto
19 sugjerime, sjellje të Mbrojtjes, pra, janë thjesht mbrojtje dhe
20 sjellje normale në mënyrë që të mund të realizohet procesi i
21 rregullt ligjor.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.

23 Z. Young.

24 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar Gjykatës,
25 nuk kam gjë për të shtuar. Thjesht dua të them që jemi plotësisht

1 dakord me parashtrimet e bëra nga z. Hooper dhe nga z. Emmerson.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

3 Znj. Alagendra.

4 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe ne jemi
5 plotësisht dakord me parashtrimet e bëra nga z. Hooper dhe z.
6 Emmerson. Por do të doja t'i jap fjalën kolegut tim për sa i takon
7 çështjes së nxjerrjes së materialeve dhe çështjeve të tjera të
8 ngritura prej jush, i nderuar z. Gjykatës.

9 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit, i
10 nderuar Gjykatës. Do të jem shumë i shkurtër sepse çështjet
11 kryesore u ngritën nga z. Hooper.

12 Arsyeja sepse iu bashkuam kërkesës së z. Thaçi lidhur me
13 nxjerrjen e materialeve është për shkak të arsyes se ne po hasemi
14 në vështirësi shumë të mëdha lidhur me materialet që na janë
15 parashtruar nga pala tjetër. Çdo avokat që lexon një intervistë me
16 një dëshmitar dhe në qoftë se haset në një dokument i cili
17 përmendet aty, gjëja normale që mund të bëjë avokati është të
18 gjejë këtë material. Pra, të gjejë dokumentin, të dijë se çfarë
19 është ky material, të dijë se çfarë ka thënë dëshmitari, dhe në
20 qoftë se ajo çfarë ka thënë dëshmitari është e besueshme apo jo.
21 Dhe na ndodh herë pas herë që këtë gjë nuk e bëjmë dot.

22 Dhe pjesë e problemit është ajo çfarë z. Hooper iu referua si
23 qasje e segmentuar, e fragmentuar. Kështu që do të ishte shumë
24 herë më mirë në qoftë se Prokuroria do të kishte dhënë
25 informacionin që mbështetet mbi dëshmitarë specifikë. Pra, ne na

1 thuhet që dikur në të ardhmen do të marrim, le të themi, një
2 paketë tjetër informacioni, ndërkohë që më vonë nga kjo pikë do të
3 marrim informacion tjetër. Dhe çfarë do të thotë kjo për neve?
4 Është që ne duhet t'i kthehemi herë pas here intervistave në
5 varësi të paketave të informacionit që marrim nga Prokuroria.

6 Kjo, në vetvete, nuk është se na ndihmon fare ne si Prokurori
7 [sipas përkthimit] në procesin tonë. Dhe për këtë arsye jemi
8 plotësisht dakord me pikat e ngritura si nga z. Hooper dhe nga z.
9 Emmerson dhe, siç e thashë dhe më sipër, i pranojmë dhe jemi
10 plotësisht dakord me to.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

12 Përpara se t'i jap fjalën Prokurorisë sërish, le të përpigemi
13 që të zgjidhim problemet e ngritura nga Prokuroria në mënyrë
14 mirëbesuese, në mënyrë bashkëpunuese, dhe në qoftë se është e
15 mundur në një qasje që nuk është shumë konfrontuese.

16 Së pari, më lejoni t'u kujtoj që në përputhje me rregullën
17 103 të Rregullores, çdo informacion potencial shfajësues duhet që
18 të nxirret në mënyrë të menjëhershme në momentin që është nën
19 ruajtjen, kontrollin, apo njohurinë aktuale të ZPS-së. Vërej
20 gjithashtu që në përputhje me vendimin që unë kam nxjerrë, ZPS-ja
21 ka deri më datë 23 korrik që të përmbushë parashikimet e rregullës
22 102(1)(b) që ka të bëjë me detyrimet për nxjerrjen.

23 Jam plotësisht dakord me Mbrojtjen që ofrimi i
24 dokumentacionit dhe i analizës që do të duhet për dëshmitarët
25 është shumë i vështirë të bëhet në qoftë se ky informacion nuk

1 jepet i plotë.

2 Si rezultat, në mënyrë që Mbrojtja të ketë mënyrë -- të ketë
3 mundësi që të përgatitet shpejt për procesin gjyqësor, do të ishte
4 e dobishme për ZPS-së që t'i përcaktonte përparësinë nxjerrjeve të
5 materialeve të cilat referohen te deklaratat e dëshmitarëve dhe te
6 në rastin -- dhe këtë gjë duhet ta bëjnë kur nxjerrin
7 informacionin në të ardhmen, po gjithashtu edhe lidhur me
8 informacionet që ata i kanë nxjerrë deri tani.

9 Për më tepër, do të doja që të inkurajoja ZPS-në, deri në
10 masën që është e mundur, që të sigurojë që në të ardhmen
11 intervistat e dëshmitarëve dhe përkthimet përkatëse të tyre të
12 nxirren në të njëjtën dosje nxjerrëse të informacionit. Kjo do ta
13 ndihmonte Mbrojtjen që të ishte më e shpejtë në punën e vet dhe do
14 të ishte me vlerë gjithashtu edhe për afatet kohore të fazës
15 paragjyqësore në tërësi.

16 Po ashtu në të ardhmen, në qoftë se ekipet e Mbrojtjes nuk
17 janë në gjendje që t'i referohen një dokumenti të caktuar në
18 intervistën e dëshmitarit apo të akuzuarit, duhet që pikë së pari
19 të kontaktojnë me ZPS-në dhe pastaj t'i drejtohen Gjykatës.

20 Zonja Prokurore, pas këtij debati, a dëshironi të shtoni
21 diçka sa i takon kësaj pike diskutimi dhe sa i takon masën
22 ndregëse të propozuar nga Mbrojtja?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

24 Ajo çfarë mund të bëj unë është që të përsëris sërish faktin
25 që ZPS-ja është e angazhuar për të plotësuar të gjitha paketat me

1 informacion. Kemi thënë që do të bëjmë të pamundurën për të
2 përmbushur këtë informacion, do të marrim parasysh urdhrin tuaj, i
3 nderuar Gjykatës, dhe do të përcaktojmë si përparësi nxjerrjen e
4 atyre informacioneve që mundemi.

5 Sa i takon intervistave të dëshmitarëve në të njëjtën paketë
6 informacioni, kjo është diçka që ne synojmë të bëjmë. Ka pasur
7 disa shembuj të vegjël të cilët janë theksuar nga Mbrojtja e z.
8 Krasniqi, kur një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Thua se të gjithë
9 këta shembuj janë marrë nga paketat e nxjerra 9 dhe 10. Dhe siç e
10 mbani mend, besoj këto janë nxjerrje që kanë të bëjnë me material
11 mbështetës të aktakuzës që janë nxjerrë në një periudhë kohore
12 prej tre orësh me njëra-tjetrën dhe ka qenë një çështje e cila
13 lidhej me vështirësitë teknike të ZPS-së. Dhe nuk ka qenë
14 asnjëherë synimi i ZPS-së që të bëhej fjalë për paketa të ndryshme
15 informacioni.

16 Ju thatë po ashtu që, kur është e mundur, të përfshihen
17 përkthimet në të njëjtat paketa nxjerrjeje. Do doja të thosha që
18 kjo jo gjithmonë është e mundur sepse ende po punojmë me
19 përkthimin e deklaratave të dëshmitarëve, dhe përkthimet në shqip
20 ka të ngjarë që të nxirren në një fazë të mëvonshme.

21 Lidhur me parashtimet e z. Hooper për masa të tjera
22 ndreqëse, nuk do të shprehëm për momentin por do t'i trajtoj ato
23 pak më vonë. Sa i takon parashtimit se Mbrojtja duhet të
24 këshillohet që të ngrejë çështje ndërmjet palëve, parashtimi ynë
25 lidhur me këtë është mbështetur në një numër të konsiderueshëm

1 jurisprudence ekzistuese. Dhe z. Hooper këtu sot tha që shumë prej
2 këtyre çështjeve ose janë trajtuar, ose mund të trajtohen në bazë
3 *inter parte*, pra, ndërmjet palëve.

4 Sa i takon parashtimeve të z. Veseli për pretendimet për
5 mirëbesim apo keqbesim, unë nuk dua ta komentoj këtë gjë, por do
6 të doja të thosha që ky është një koment i cili vjen nga një
7 avokat që ka bërë konstatime të tilla të ngjashme si për ZPS-në
8 ashtu dhe për persona -- për anëtarë individualë të zyrës tonë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

10 Nuk shoh se ka ndonjë kërkesë për të vijuar më tej, kështu që
11 besoj që mund të vazhdojmë me numrat ERN.

12 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë dua të flas,
13 z. Gjykatës.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper, shumë shkurt sepse
15 do të kalojmë në pika të tjera të rendit të ditës për sot.

16 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Më lejoni të them
17 që jam i lumtur që dëgjoj për paketimin dhe, siç e thashë dhe më
18 sipër, duhet që të kapet ritmi. Kaq kisha për të thënë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

20 Le të vazhdojmë me numrat ERN.

21 Mbrojtja e Thaçit dhe Krasniqit kanë kërkuar një urdhër për
22 ZPS-në që të ofrojë një numër të saktë dhe të plotë të referencës
23 së provës, të quajtur ndryshe ERN, lidhur me transkriptin e
24 intervistës apo deklaratës. Mbrojtja kërkon që në qoftë se kjo
25 qasje nuk do të -- nuk është bërë deri tani, atëherë mangësitë do

1 të duhen të përmbushen brenda katër javëve.

2 Dua që të falënderoj Mbrojtjen për ngritjen e kësaj çështjeje
3 dhe për ZPS-në për zgjidhjen e dhënë. Tani do të doja t'u kërkoja
4 palëve që të konfirmonin në qoftë se çështja është zgjidhur apo
5 jo.

6 Zonja Prokurore, fjala për ju.

7 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kjo çështje
8 specifike nuk është zgjidhur ende, por pika katër është zgjidhur.

9 Megjithatë, përveç faktit që ka çështje që referohen në
10 intervistat të cilat nuk janë nxjerrë ende, ose do të nxirren si
11 pjesë e materialit mbështetës të aktakuzës, lidhja e këtyre
12 materialeve nuk është përfunduar ende. Megjithatë, neve do t'i
13 nxjerrim këto materiale si çështje përparësie, siç u referua prej
14 jush, i nderuar Gjykatës, edhe do t'i lidhim me dëshmitarët
15 përkatës. Mbrojtja do të informohet për çështjet në fjalë që
16 shpresoj dhe besoj që do t'i përgjigjen shqetësimeve të tyre.

17 Shembujt e ofruar në dosjen e Mbrojtjes së z. Thaçi kishin të
18 bënin me vështirësi që janë identifikuar në provat materiale që
19 kanë të bëjnë vetëm me intervistat e z. Thaçi. Këto çështje janë
20 nxjerrë së bashku me shpjegimet përkatëse. Paragrafi 12 i
21 përgjigjes së Mbrojtjes së z. Thaçi, i cili thotë që ka 54 prova
22 materiale të cilat janë përdorur në intervistën e z. Thaçi në
23 korrik, më datë -- ky është një parashtrim i cili është bërë nga
24 Mbrojtja më datën 17 mars, më duhet të them, i nderuar Gjykatës,
25 që kjo nuk qëndron.

1 Së pari, nuk bëhet fjalë për 54 prova materiale të përdorura
2 në korrik, pra, në intervistën e bërë nga z. Thaçi, por kemi të
3 bëjmë me 15 prova materiale të përdorura në janar dhe 39 të tjera
4 të cilat janë përdorur në korrik.

5 Së dyti, të gjitha provat e përdorura në intervistën e
6 korrikut janë nxjerrë si pjesë e materialeve mbështetëse të
7 aktakuzës. Ato përfshihen në paketat e nxjerrjes 9 dhe 13 të
8 ofruara në dhjetor të vitit 2020.

9 Këto zëra, këto çështje jo vetëm janë nxjerrë, por ashtu siç
10 u tha nga z. Hooper, ZPS-ja i ka dhënë Mbrojtjeve, mbi bazë *inter*
11 *partes*, tabela të detajuara ku bëhen referencat e dokumenteve, të
12 numrit të referencës së provave, dhe informacioneve të tjera.
13 Kështu që nuk mendoj se ka arsye për pasaktësinë e parashtimit në
14 fjalë.

15 Përveç kësaj, siç e thashë edhe më sipër, shpresoj që kjo
16 çështje do të zgjidhet ndërkohë që ne do të vazhdojmë që të
17 nxjerrim materiale të tjera dhe do të vazhdojmë t'i lidhim këto
18 materiale me dëshmitarët përkatës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

20 Për sa i takon çështjes së numrave ERN, z. Hooper.

21 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Siç e përmenda dhe
22 më parë, një antidodë e vështirësive që kanë dalë do të ishte që
23 Prokuroria thjesht të jepte një tabelë që është një procedurë
24 shumë e thjeshtë, pra, të jepte një tabelë me të gjithë numrat ERN
25 të lidhur me secilin prej dëshmitarëve dhe mendoj që kjo në

1 vetvete do të ishte zgjidhje.

2 Pra, unë nuk pranoj zonja Lawson -- ashtu siç thatë ju më
3 përpara, sa i takon paragrafit 12, pra, më duhet të them që nuk
4 jam dakord me të lidhur me numrin e provave apo të dokumenteve
5 ERN, të provave materiale të cilat ajo përmendi në parashtimin e
6 saj pak momente më parë.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

8 Z. Emmerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam gjë për
10 të shtuar.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

12 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Jo, nuk kam gjë as
13 unë për të shtuar.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.

15 Znj. Alagendra.

16 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Z. Ellis do
17 të trajtojë çështjet për nxjerrjen.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

19 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar Gjykatës,
20 ne jemi në mbështetje të parashtimeve të bëra nga Mbrojtja e z.
21 Thaçi. Pra, është e nevojshme për neve që të kemi një tabelë me
22 numrat ERN për secilin prej dëshmitarëve. Kjo do të zgjidhte
23 problemin dhe kjo është e domosdoshme për ne për të bërë punën
24 tonë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Ellis.

1 Zonja Prokurore, lidhur me këtë propozim të z. Ellis, a
2 mendoni që çështja e ngritur mund të zgjidhet përpara Konferencës
3 tjetër për Ecurinë e Çështjes?

4 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Lidhur me kërkesën për tabelën, kjo
5 nuk është diçka që ne e kemi të disponueshme aktualisht, d.m.th.,
6 nuk është diçka që mund ta printojmë drejtpërdrejt, se po të
7 ishte kështu do të mund t'ua vinim në dispozicion pa problem, por
8 ka një nivel domethënës të punës manuale që do të duhet të bëhet
9 për përgatitjen e tabelës.

10 Siç e parashtrova pak më parë, besojmë se në momentin kur
11 materialët dhe provat materiale të nxirren dhe të lidhen me
12 dëshmitarët, besoj që kjo mund të zgjidhë problemin. Në qoftë se
13 jo, jemi të gatshëm që të diskutojmë çështje të tjera në atë fazë
14 që do të çonte në një kuptim më të mirë të Mbrojtjes të
15 dokumenteve përkatëse.

16 Atëherë, sa i takon kohës, i nderuar Gjykatës, pra, në qoftë
17 se kemi mundësi që të japim këto informacione deri në Konferencën
18 e radhës për Ecurinë e Çështjes, për momentin nuk mund t'jua them
19 një gjë të tillë. Pra, sa i takon materialeve të cilat janë
20 nxjerrë, pa diskutim që ne do të shikojmë në mënyrë të detajuar
21 brendapërbrenda për të parë se çfarë mund të bëjmë dhe në qoftë se
22 mund të bëjmë diçka, pa diskutim që do ta vëmë këtë informacion në
23 dispozicion për Mbrojtjen.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për këtë temë, do të doja që
25 t'i inkurajoja palët që të vijojnë me diskutimet *inter partes*, në

1 mënyrë që problemet, nëse është e mundur, të mund të zgjidhen
2 përpara Konferencës së radhës për Ecurinë e Çështjes.

3 Le të kalojmë te pika tjetër që ngrihet nga kërkesa e Thaçit.

4 Mbrojtja e Thaçit dhe e Krasniqit kërkojnë një urdhër nga
5 ZPS-ja -- një urdhër për ZPS-në që të nxjerrë të gjithë
6 regjistrimet audio dhe video për të gjithë dëshmitarët dhe
7 intervistat e të akuzuarve. Mbrojtja kërkon po ashtu që në qoftë
8 se kjo qasje nuk është përdorur deri tani, të gjitha regjistrimet
9 audio dhe video që lidhen me intervistat e dëshmitarëve dhe të
10 akuzuarve të mund të nxirren brenda katër javëve.

11 Do të doja që të dëgjoja palët lidhur me këtë çështje. Së
12 pari dua të dëgjoj ZPS-në në qoftë se ekzistojnë regjistrime audio
13 dhe video për prova të tilla materiale për të gjithë dëshmitarët,
14 dhe do të doja që ZPS-ja gjithashtu të flasë për çështje praktike
15 dhe sfida teknike që mund të kenë të bëjnë me nxjerrjen e
16 regjistrimeve audio dhe video.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

18 Edhe kjo është një çështje që nuk është ngritur *inter partes*,
19 dhe në fakt është një kërkesë e cila është bërë pa bërë të ditur
20 bazën ligjore, apo është e pabazuar.

21 Sa i takon asaj nëse ka apo jo incizime audiovizive për të
22 gjitha intervistat e dëshmitarëve, them që nuk ka. Ka incizime
23 audiovizive për pjesën më të madhe të intervistave që ka bërë
24 Prokuroria, dhe kur janë zbardhjet e teksteve, transkriptime pra,
25 ato janë nxjerrë nga incizimet audiovizive. Dhe për pasojë do të

1 thotë që ekziston një incizim, pra, kur ka transkriptim.

2 Në përgjigjen e vet Mbrojtja e Thaçit përpiket që të
3 mbështetet në një vendim të Gjykatës Penale Ndërkombëtare të vitit
4 2010. Në fakt, është -- nuk është referimi i duhur për një sërë
5 arsyes.

6 Së pari, ky është një vendim i cili është kundërshtuar nga
7 jurisprudenca e mëpasshme, përfshirë, në mes të tjerash, edhe
8 shumë vendime të cituara në paragrafin 16 të përgjigjes tonë. Por,
9 së dyti, dhe mbase më e rëndësishmja, është se vendimi në çështjen
10 Katanga kishte të bënte me nxjerrjen e incizimeve audio vetëm
11 atëherë kur ishte nxjerrë një deklaratë e nënshkruar e
12 dëshmitarit, dhe jo transkripti fjalë për fjalë. Në rastin në
13 fjalë situatën e kemi shumë ndryshe, sepse ne i kemi vendosur në
14 dispozicion Mbrojtjes transkriptimet në anglisht dhe në shqip që
15 reflektojnë fjalët e thëna në intervistë.

16 Sa i takon vështirësive praktike, bëhet fjalë për materiale
17 të konsiderueshme. Çdo redaktim që është përdorur në transkriptim,
18 besoj e imagjinoni që duhet bërë dhe në incizim, pra, fshirjet
19 përkatëse në mënyrë që masat mbrojtëse të mbeten efektive. Kjo nuk
20 është e lehtë. Do të kërkonte një softuerë të specializuar të
21 cilin nuk ma merr mendja se e ka Prokuroria, ose të paktën nuk e
22 ka në atë formë e cila do të na jepte mundësi që ta bënim këtë
23 gjë. Kjo vlen jo vetëm për nxjerrjen me vonesë të -- për
24 dëshmitarët e mbrojtur, por të gjitha transkriptet d.m.th., kur
25 përdoren redaktimet standarde. Pra, është diçka e cila nuk besoj

1 se mund të bëhet menjëherë.

2 Unë besoj se këto janë parashtrimet e mia për këtë temë. Por
3 dua të përmend edhe se z. Hooper tashmë e ka bërë të ditur se kjo
4 nuk përbën prioritet për Mbrojtjen aktualisht. Faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

6 Z. Hooper, fjala për ju.

7 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk jam dakord me
8 znj. Lawson, nuk kam asgjë kundër saj. Jemi si një ekip me thënë.

9 Nuk -- është më se e logjikshme se nëse nuk ka -- se nuk kemi
10 incizim dëgjimor në dispozicion, ose më saktë, nëse Prokuroria ka
11 materiale të tilla pra, audiovizive, duhet t'ia vendosi Mbrojtjes
12 --

13 Po kështu, unë e di pra, që nëse një fjalë është e përkthyer
14 në një gjuhë, në anglisht për shembull, është thënë një fjalë në
15 shqip, është përkthyer në anglisht si "dëshmitar", por në fakt
16 personi nuk tha "dëshmitar", ka thënë "person", pra, nuk është më
17 fjala "dëshmitar". Unë thjesht dua që të kontrolloj ato gjëra që
18 janë të rëndësishme.

19 Jam dakord, i kuptoj vështirësitë. Por nëse do të na jepej
20 mundësi që të kontrollojmë një intervistë shumë të gjatë, dhe
21 pastaj të dëgjojmë -- dhe të kemi dhe audion, në fillim do të
22 dëgjosh audion ndërkohë që e lexon intervistën. Se përndryshe
23 ç'kuptim ka që e mban materialin audio Prokuroria? Për të
24 kontrolluar saktësinë.

25 Në fakt kemi marrë përkthimet nga shqipja në anglisht. Shumë

1 prej këtyre përkthimeve nuk kanë qenë veçanërisht të mira. Na
2 duhen transkripte -- jo më falni, jo transkriptet, por na duhet
3 mundësia që t'i dëgjojmë vetë dhe t'i kontrollojmë këto materiale
4 përmes personave që marrin vesh nga gjuha. Faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Një pyetje të shkurtër. Ju me të drejtë ngrini çështjen e
7 rrezikut të gabimeve të mundshme në përkthim. Vërtet ju duhet
8 incizimi audiovizivë? Nëse ju e keni materialin origjinal në
9 shqip, dhe ky version origjinal i transkriptit përkthehet në
10 anglisht, a nuk do të mjaftonte kjo për të kontrolluar ndonjë
11 gabim të mundshëm të përkthimit?

12 Ndizni mikrofonin, ju lutem. Nuk ju shikojmë në video. Ju
13 lutem, edhe mikrofonin edhe videon ta ndizni, z. Hooper. Tani ju
14 shikojmë por nuk ju dëgjojmë ende. E keni të fikur mikrofonin.

15 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, edhe mundet.
16 Është shumë më e gjatë ta lexosh, është më lehtë ta lexoni --
17 është më gjatë ta lexosh, është më lehtë dëgjosh. Pastaj
18 transkripti, për ta parë transkriptin të duhet dhe audio.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

20 Z. Emerson.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë thelbësore
22 përveç asaj që është e dukshme, që kur dëgjon audion dhe sidomos
23 kur intervista është kryer përmes një përkthyesi, padyshim që
24 mundet që të ketë infiltruar ndonjë gabim për shkak të
25 interpretimit pra, të përkthimit. Këtë mund ta kuptosh vetëm në

1 incizim pra, dhe është e rëndësishme që të kontrollohet.

2 Dhe një prej këtyre gjërave që janë të rëndësishme për t'u
3 kontrolluar, sipas pikëpamjes tonë, është që ndonjë fjalë e
4 dëshmitarit apo e të intervistuarit është -- mund të mos jetë
5 përkthyer saktë gjatë intervistës.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson.
7 Z. Young.

8 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Shumë shkurt, për
9 të mbështetur atë që thonë z. Hooper dhe Emmerson.

10 Pra, nuk është thjesht për të kontrolluar saktësinë. Kjo
11 është me rëndësi sigurisht, por edhe kur shikon materialin
12 audioviziv është me shumë rëndësi të ndjekësh edhe intonacionin,
13 sepse shumë mund të kuptohet nga intonacioni dhe gjestet. Është
14 shumë e rëndësishme për ne që të kuptojmë, të bëjmë një verifikim
15 të transkriptit, sepse mund të ketë edhe në transkript ndonjë
16 gabim.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.
18 Z. Ellis, ju lutem.

19 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar Gjykatës,
20 asgjë për të shtuar, përveçse të themi që mbështesim kërkesën e
21 kolegëve tanë.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Ellis.
23 Zonja Prokurore, çfarë keni për të thënë.

24 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dua që të bëj një sqarim të shkurtër.
25 Disa prej avokatëve kanë përmendur nevojën për të kontrolluar

1 interpretimin apo përkthimin, por për të gjitha intervistat e
2 kryera në shqip, transkripti që është vendosur në dispozicion --
3 nuk janë transkripte të përkthyer. Fjala e thënë në origjinal në
4 shqip është zbardhur, është vendosur në transkriptim dhe kjo iu
5 është vendosur në dispozicion. Dhe ashtu sikurse dhe fjala e thënë
6 në anglisht është zbardhur në transkript dhe ashtu është vendosur
7 në dispozicion. Çdo gabim interpretimi apo përkthimi del qartë nga
8 transkripti.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

10 Do të jap një vendim gojariht për këtë më pas, në fund të
11 seancës.

12 Më lejoni tani që të kaloj te çështja e numrave të
13 dëshmitarëve.

14 Mbrojtja e Thaçit dhe Krasniqit kërkojnë lëshimin e një
15 urdhri që ZPS-ja të vendosë në dispozicion numrat e dëshmitarëve
16 për të gjitha materialet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me
17 dëshmitarët, identitetet e të cilëve nuk i janë bërë të ditura
18 Mbrojtjes. Avokatët e Mbrojtjes kërkojnë gjithashtu që nëse kjo
19 qasje nuk ndiqet -- që nëse kjo qasje nuk është ndjekur deri tani,
20 çdo mangësi të ndreqet brenda katër javëve të ardhshme.

21 Në fillim do t'i kërkoj ZPS-së të konfirmojë nëse në të
22 vërtetë kjo është bërë në të gjitha rastet, me përjashtim të
23 rasteve kur kanë masa mbrojtëse. I lutem ZPS-së të konfirmojë që
24 numri i vogël i rasteve kur nuk është bërë kjo gjë, ka të bëjë me
25 dëshmitarë për të cilët janë miratuar masat mbrojtëse.

1 Zonja Prokurore.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, kështu është.
3 Siç e bëri të ditur avokati mbrojtës i Thaçit në pikën e parë të
4 rendit të ditës, ZPS-ja e ka -- i ka dhënë zgjidhje kësaj
5 çështjeje dhe ka bërë ç'është e nevojshme për të vendosur në
6 dispozicion kode për atë numër të vogël rastesh kur nuk e kishim
7 bërë këtë gjë.

8 Avokati i Mbrojtjes ka bërë të ditur se duhet përshpejtuar
9 puna, por në fakt është përshpejtuar, dhe u bë me të na e sjellë
10 në vëmendje këtë problem.

11 Ne e kemi thënë në përgjigjen tonë se të gjitha, me
12 përjashtim të gjashtë materialeve sipas rregullës 102(1)(b), për
13 këto kemi vendosur në dispozicion kodet e dëshmitarëve. Për ato
14 gjashtë të mbeturat që nuk mund të lidhen në këtë pikë me masat
15 mbrojtëse, kanë të bëjnë me dëshmitarë për të cilët masat
16 mbrojtëse janë miratuar tashmë.

17 Sa i takon materialeve të rregullës 102(1)(a), ne e kemi
18 shqyrtuar përshkrimin e të gjitha deklaratave që janë vendosur në
19 dispozicion si pjesë e këtij materiali. Dhe në paketën e nxjerrjes
20 numër 25, kemi rinxjerrë 36 materiale me kodet e përfshira. Pra,
21 kemi shqyrtuar jo vetëm shembujt e veçantë që ka përmendur
22 Mbrojtja, por të gjitha deklaratat e mbrojtësve të mbrojtur -- e
23 dëshmitarëve të mbrojtur të cilat janë përfshirë në materialin
24 mbështetës të aktakuzës. Pra, unë mendoj që është zgjidhur kjo
25 çështje. Faleminderit.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

2 Z. Hooper.

3 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po, është
4 zgjidhur. Faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

6 Z. Emerson.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] S'kam gjë për të
8 shtuar.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. Young.

11 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

13 Z. Ellis.

14 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për të
15 shtuar. Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

17 Si pikë të fundit në lidhje me këto parashtime, dëshiroj të
18 them se përgjigjja e Mbrojtjes së Thaçit është parashtuar në
19 mënyrë konfidenciale, mirëpo, avokati i Mbrojtjes i Thaçit ka bërë
20 të ditur se nuk ka kundërshtim që të riklasifikohet si publik.

21 Dëshiroj që t'i kërkoj ZPS-së nëse ka kundërshtim që të
22 riklasifikohet parashtimi F236 si publik?

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Më duket se paragrafi 15 diskuton
24 shembuj të provave të disa dëshmitarëve të caktuar të cilat më
25 përpara ishin pjesë e shtojcës së kërkesës fillestare të

1 Mbrojtjes. Do të kërkonim që të redaktoheshin pjesët përkatëse kur
2 të bëhej parashtrimi i redaktuar publik. Më duket se është
3 paragrafi 15. Po ai është. Faleminderit.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

5 Z. Hooper, keni për të thënë diçka lidhur me këtë?

6 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk e kuptoj përse
7 ka nevojë për redaktim numri 15? Mund ta gjykoni vetë ju, z.
8 Gjykatës. Thjesht, përmend numrat e dëshmitarëve. Nuk --
9 përmendet, thuhet aty një skicë apo pika orientimi, po s'ka asgjë
10 tjetër që aty të identifikohet dikush.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

12 Zonja Prokurore, dëshironi të shtjelloni këtë pikë lidhur me
13 paragrafin 15?

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ky paragraf në të
15 vërtetë përshkruan prova materiale, skica, fotografi dhe materiale
16 të tjera të përdorura me dëshmitarë të veçantë, përfshirë këtu
17 përmendjen e numrave ERN të transkripteve të dëshmitarëve.
18 Sigurisht, hə për hə, ky është informacion konfidencial, por ia
19 lëmë në dorë të nderuarit Gjykatës që të vendosë nëse është i
20 nevojshëm redaktimi në këtë rast apo jo.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

22 Z. Hooper, shumë shkurt.

23 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] A mundet, e
24 nderuara kolege, të përmend një rast të vetëm që mund të
25 përshkruhet?

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më falni z. Hooper, a mund ta
2 përsërisni sepse kishte probleme me lidhjen.

3 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po. Kolegia
4 përmendi faktin se përmenden materiale specifike, po a mundet --
5 aty s'ka asgjë që mund të identifikojë ndonjë person. Aty
6 përmendet një hartë që nuk është vendosur në dispozicion, dhjetë
7 fotografi të pavendosura në dispozicion. Unë mendoj që kjo
8 ilustron që ZPS-ja e tepron me redaktimet. Ky është shembull tipik
9 i mentalitetit të tyre. Nuk mund të shtrydhim këtë paragraf për të
10 nxjerrë çdo gjë e cila shumë pak, shumë pak mund të zbulojë diçka.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zoti avokat, z.
12 Hooper.

13 Zonja Prokurore, doni të shtoni ndonjë gjë?

14 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Jo. Jua lë juve në dorë. Por unë për
15 shembull, dua të nënvizoj faktin që aty përmendet direkt
16 transkripti i dëshmitarit. Faleminderit.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po. I kthehem tani Prokurorisë
18 përsëri, sepse do të merremi me pikën e fundit që ka të bëjë me
19 nxjerrjen e materialeve në rendin e ditës, që ka të bëjë me
20 kalendarin.

21 Në parashtrimet e veta për Konferencën për Ecurinë e
22 Çështjes, ZPS-ja kërkon shtyrjen e afatit për vendosjen në
23 dispozicion të njoftimit të hollësishëm sipas rregullën 102(3), që
24 të jetë tashmë dita e premte, datë 25 qershor 2021.

25 Dëshiroj që t'i jap fjalën palëve, duke filluar me ZPS-së, që

1 të flasin lidhur me këtë kërkesë.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

3 Në lidhje me njoftimin sipas rregullës 102(3), qëllimi i
4 këtyre përshtatjeve është që të përshtaten këto afatet për të bërë
5 të mundur që të gjitha çështjet dhe të gjitha materialet që janë
6 të nevojshme për Mbrojtjen të jepen deri -- në kohën e duhur.

7 Siç kemi thënë edhe në parashtimet e mëparshme dhe në
8 Konferencat e mëparshme për Ecurinë e Çështjes që ZPS-ja duhet të
9 jetë në një fazë të përparuar të procesit të nxjerrjes së
10 materialeve, sipas rregullës 102(1)(b), në mënyrë që t'i japë këtë
11 njoftim Mbrojtjes. Këto procese duhet të jenë paralele -- në qoftë
12 se këto procese bëhen paralele, atëherë këto do ta pengonin
13 nxjerrjen e materialeve sipas rregullës 103, dhe do të binin ndesh
14 me nxjerrjen e materialeve -- materialet do të binin ndesh me
15 njëra-tjetrën.

16 Pra, nuk do të ishte efikase që të arrijnë të bëhen kërkesa
17 nga Mbrojtja, dhe pastaj Prokuroria t'i japë përgjigje kërkesave
18 të Mbrojtjes në lidhje me materiale të cilat mund të dorëzohen së
19 shpejti në bazë të rregullave.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper, keni gjë për t'u
21 përgjigjur?

22 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Emmerson.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për të
25 shtuar.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

2 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për të
3 shtuar.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis.

5 Z. ELLIS: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për të
6 shtuar.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Unë do të jap një urdhër në
8 lidhje me këtë çështje në fund të seancës.

9 Tani, do t'i kërkoj Prokurorisë të flasë për ecurinë e
10 hetimeve të tyre; nëse mund të japin një datë për përfundimin e
11 hetimeve të mbetura, ende të pazhvilluara; dhe nëse mund të na
12 jepni një datë të përafërt se kur mund të dorëzoni dosjen
13 paraprake në lidhje me kalendarin e përgjithshëm në bazë të
14 Vendimit Kuadër -- Vendimit Kornizë dhe vendimit i cili është
15 amenduar në bazë të rregullës 109(c).

16 Zonja Prokurore.

17 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Unë do të respektoj udhëzimet që janë
18 dhënë deri tani dhe nuk do të flas shumë gjatë. Dua të theksoj që
19 është shumë e rëndësishme që të mbahet një lidhje përkatëse midis
20 afateve të përcaktuara për secilën fazë.

21 Siç e kemi thënë edhe në parashtimet me shkrim, ne
22 parashikojmë që materialet sipas rregullës 95 [sipas përkthimit]
23 t'i dorëzojmë në javën e dytë -- deri në javën e dytë të shtatorit
24 2021.

25 Arsyeja për këtë ndryshim në afatin kohor është për shkak të

1 afateve të reja që keni vënë ju, i nderuar Gjykatës, në vendimin
2 tuaj për rikategorizimin e provave. Dhe ndonëse ne tani jemi të
3 fokusuar te detyrimet që kemi për sa i përket nxjerrjes, dhe i
4 kemi fokusuar të gjitha burimet në këtë aspekt, kjo shton --
5 nënkategorizimi i materialeve kërkon kohë dhe burime të tjera të
6 konsiderueshme që e zgjat kohën e përfundimit të kësaj procedure.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper.

8 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë -- mua më
9 çudit ajo që thotë Prokurorja për sa i përket hetimeve.

10 Së pari, çfarë nevoje ka për të bërë hetime në këtë fazë që
11 jemi? Jemi këtu sot, është data 24 mars, 22 vjet mbasi NATO bëri
12 bombardimin për të ndaluar agresionin serb kundër Kosovës. 22 vjet
13 më parë dhe ja ku jemi sot në vitin 2021 me një aktakuzë që jua
14 kanë parashtruar deri në imtësi. Çfarë nevoje ka që Prokuroria të
15 bëjë hetime të mëtejshme?

16 Më duket sikur këtë e bëjnë për të përforcuar një dosje që
17 nuk është aq e fortë. Tani, si mund ta thonë që kjo nuk mund të
18 pengojë Gjykatën në punën e saj? Si mund të thonë që kjo nuk do të
19 ketë pasoja për datën se kur do të fillojë gjykimi? Nuk e kuptoj.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

21 Z. Emerson.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Në Konferencën e
23 fundit për Ecurinë e Çështjes, ju thatë që ju nuk do të kërkonit
24 parashtrim me shkrim. Dhe unë në parashtrimet e mia me gojë gjatë
25 konferencës së kaluar, unë kërkoja që ju të bënit shkëputjen e

1 lidhjes që bën Prokuroria midis dorëzimit të dosjes paraprake dhe
2 datës së fillimit të gjyqit.

3 Kjo çështje mbetet ende e pazgjidhur. Dhe unë nga
4 parashtrimet e Prokurorisë sot, kuptoj që ata s'e kanë kuptuar
5 mesazhin që ju kemi përcjellë se është shumë e rëndësishme për
6 Mbrojtjen që të fillojë përgatitjet e saj që të ketë dosjen
7 paraprake, dhe sa më shpejt që të jepet kjo dosje paraprake aq më
8 e lehtë bëhet puna jonë.

9 Ne i përmbahemi këtij pozicioni dhe kërkojmë ju që -- ju
10 kërkojmë juve që të merrni vendim në lidhje me të. Ne nuk do të
11 fillojmë të diskutojmë se kur do të fillojë gjykimi, por të paktën
12 përkohësisht të jepet njëllorj rendi, sepse siç e dëgjuat, kolegu
13 im tha që Prokuroria po i bën këto fazat dhe dhënien e materialeve
14 në mënyrë shumë të shkëputur dhe rastësore. Dhe ne themi që
15 Prokuroria, të paktën deri në mes të qershorit, të na thotë hapur
16 se çfarë pozicioni ka dhe të japë një dosje të detajuar paraprake.

17 Ne kemi paralajmëruar që në fillim dhe kemi thënë që
18 kundërshtimi i Prokurorisë në përgjithësi për sa i përket afateve
19 kohore nuk është i saktë, dhe afatet kohore që paraqet Prokuroria,
20 ne themi që nuk janë të sakta dhe nuk janë realiste. Por
21 Prokuroria vazhdon të thotë, siç e tha edhe z. Smith në seancën e
22 kaluar, që ai do ta dorëzojë dosjen paraprake në momentin më të
23 fundit të mundshëm përpara sesa të fillojë gjykimi.

24 Dhe unë e di se çfarë vendimi keni dhënë ju, i nderuar
25 Gjykatës, dhe mendoj që duhet të fokusoheni te data që do të

1 dorëzohet dosja paraprake, në mënyrë që ne ta dimë se çfarë është
2 paraqitur kundër nesh dhe të fillojmë të përgatitemi. Ky është
3 procesi mbi bazën e të cilit vepron Mbrojtja. Dhe është shumë e
4 rëndësishme që të gjitha këto faza të bëhen në mënyrë që Mbrojtja
5 të bëjë përgatitjen e duhur dhe të prioritetizojë punën -- aspektet
6 e punës së saj.

7 Çështja, të cilën e anashkalon Prokuroria në parashtrimin e
8 saj, është se nuk ka asnjë lloj justifikimi për vonimin e
9 dorëzimit të dosjes paraprake. Prandaj edhe ju ftojme ju, i
10 nderuar Gjykatës, të jepni një vendim në lidhje me këtë, të
11 caktoni një datë të hershme kur të dorëzohet dosja paraprake, në
12 mënyrë që ne pastaj të mund të përcaktojmë punën tonë dhe afatet
13 kohore të punës sonë.

14 Si rezultat i vendimeve që janë dhënë nga ju në interes të
15 drejtësisë për procesin e dorëzimit të materialeve, ne do t'i
16 përmbahemi atyre, megjithatë, nuk ka arsye Prokuroria të refuzojë
17 që të japë pozicionin e saj në lidhje me këtë çështje.

18 Z. Smith e tha herën e kaluar që Prokuroria -- ose u duk
19 qartë nga z. Smith që Prokuroria po e bën enkas që të vonojë
20 dhënien e dosjes paraprake, dhe ta japë atë sa më pak kohë para
21 fillimit të gjyqimit. Dhe unë nuk mendoj që këto justifikimet që
22 nxori z. Smith për sa i përket redaktimeve e të tjera, këto mund
23 të bëhet dhe nuk -- dhe së bashku me masat mbrojtëse nuk krijojnë
24 asnjë lloj problemi. Por, siç e thatë, nuk ka asnjë lloj
25 justifikimi për këtë, sepse në qoftë se dosja është gati, në qoftë

1 se është hartuar dosja, Prokuroria duhet ta dijë të paktën se kur
2 do ta hartojë atë, kur do ta ketë gati atë.

3 Pra, ju i nderuar Gjykatës, dhatë një vendim herën e kaluar
4 që të bëhet një parashtrim i protokolluar në lidhje me këtë. Unë
5 nuk e kam bërë këtë parashtrim ende, por mund ta bëj në një kohë
6 më të vonshme në bazë të vendimit tuaj.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Young.

8 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne mbështesim
9 parashtrimet e z. Emmerson dhe të z. Hooper. Ne e dimë shumë mirë
10 se Prokuroria ka pasur të paktën pesë vjet kohë për ta hetuar këtë
11 çështje sa duhet, dhe që ta vonojnë dorëzimin e dosjes paraprake
12 deri në shtator të këtij viti, është e papranueshme. Të pandehurit
13 në këtë çështje kanë të drejtën të dinë se çfarë është thënë
14 kundër tyre, çfarë akuzash ka kundër tyre, dhe kjo dosje duhet t'i
15 bëhet -- t'i jepet në dispozicion.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Ellis ose znj. Alagendra.

17 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Ne nuk kemi
18 asgjë për të shtuar, përveçse të theksojmë se ne i përmbahemi
19 parashtrimeve të bëra më parë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Alagendra.

21 I kthehem përkthyesve. Është ora tani 12.31. A është e
22 mundshme të vazhdojmë për 15, 20 minuta përpara sesa të bëhet
23 pushimi? Kjo do të na lejojë që të bëjmë vetëm njëherë pushim deri
24 në fund të seancës.

25 Po e shprehnit me gjeste miratimin tuaj, por xhami është kaq

1 i errët saqë nuk mund t'ju shikoja. Faleminderit.

2 Atëherë, meqë ranë dakord përkthyesit që të vazhdojmë, do të
3 vazhdojmë me pikën tjetër.

4 Zonja Prokurore.

5 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

6 Në lidhje me hetimet, Prokuroria ka një mandat të qartë dhe
7 do të vazhdojë që të bëjë hetime në bazë të atij mandati. Siç e di
8 dhe Mbrojtja, ekzistojnë procedura të ndryshme të cilat po
9 vazhdojnë njëkohësisht në lidhje me këtë mandat.

10 Për sa i përket shpjegimit në lidhje me përshtatjen e afateve
11 kohore, besoj që e shpjegova këtë.

12 Për sa i përket kërkesës së z. Veseli për dosjen paraprake,
13 është dhënë një vendim nga Gjykatësi për këtë më 12 mars, edhe në
14 lidhje me kategorizimin.

15 Lidhur me parashtimet, Mbrojtja ka një aktakuzë mjaft të
16 hollësishme që është më shumë se 50 faqe. Po kështu edhe
17 përshkrimi i detajuar, ose përmbledhja e detajuar prej 600 faqesh,
18 në bazë të rregullës 86(3)(b), do t'i japë mundësinë atyre që të
19 kenë -- dhe në bazë të vendimit të kategorizimit, do të kenë
20 mundësi Mbrojtja që të shikojnë dhe të përcaktojnë se çfarë është
21 thënë në aktakuzë.

22 Përveç kësaj, Mbrojtja ka edhe Vendimin e Konfirmimit të
23 Aktakuzës prej 260 faqesh të Gjykatësit, e cila është e
24 disponueshme në Legal Workflow.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

1 Tani do të kaloj te hetimet e Mbrojtjes. Do të pyes
2 Mbrojtjen. Ata mund të na japin më shumë informacion në lidhje me
3 ecurinë e hetimeve të tyre dhe në qoftë se Mbrojtja do të -- mund
4 t'i fillojë hetimet e veta në mes të prillit; nëse Mbrojtja mund
5 të japë informacion në lidhje me kërkesat lidhur me mundësitë
6 unike hetimore në bazë të rregullës 99(1)[sipas përkthimit]; dhe
7 nëse Mbrojtja ka ndërmend të japë informacion në lidhje me njoftim
8 për alibi apo baza për përjashtimin e përgjegjësisë penale.

9 Z. Hooper.

10 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Në lidhje me këto
11 dy çështje të fundit, s'kam asgjë për të shtuar përveç atyre që
12 thashë më parë, pra, për alibinë edhe për mundësitë hetimore
13 unike.

14 Për sa i përket hetimeve, do t'ia jap fjalën ambasadorit
15 Prosper.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prosper.

17 Z. PROSPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit z.
18 Hooper.

19 Shpresoj më dëgjoni. Jam në -- është në mes -- mesi i natës
20 këtu ku jam unë dhe duhet të flas me pëshpërime që mos të zgjoj të
21 gjithë familjen. Por besoj që kjo është edhe shprehje e
22 vështirësive që kemi në këtë fazë, i nderuar Gjykatës.

23 Për sa i përket pyetjes tuaj, t'i kthej përgjigje. Ne nuk
24 jemi në gjendje të fillojmë punët hetimore seriozisht në prill për
25 dy arsye: E para është ajo që kemi bërë -- diskutuar deri tani në

1 lidhje me nxjerrjen e materialeve. Ne duhet të marrim materialet
2 njëherë në mënyrë që të dimë se çfarë duhet të hetojmë. Sidomos
3 për sa i përket deklaratave, dokumenteve që janë marrë nga
4 organizata të ndryshme. Nuk e dimë se çfarë janë këto materiale,
5 nëse këto janë selektive apo kërkohet një hetim më i gjerësishëm i
6 tyre.

7 Unë nuk dua të them që ne nuk i kuptojmë vështirësitë që ka
8 Prokuroria dhe kompleksitetin e punës së tyre. Unë kam qenë në
9 pozitën e tyre në nivele të ndryshme më parë dhe e di, por duhet
10 t'i kërkoj Prokurorinë që ta kuptojnë edhe pozitën tonë dhe
11 kompleksitetet me të cilat përballemi ne. Sepse ne nuk jemi në
12 gjendje të përmbushim përgjegjësitë tonë mbi bazë -- sepse nuk
13 kemi informacion.

14 Desha të them se kjo nuk është thjesht një çështje
15 procedurale, është edhe çështje e të drejtave të njeriut dhe mund
16 të citoj këtu konventat ndërkombëtare, Konventën e të Drejtave
17 Civile dhe Politike -- neni 13 thotë për shembull që, të gjithë të
18 akuzuarit duhet të kenë mjetet dhe kohën e mjaftueshme për t'u
19 përgatitur dhe të kenë akses në dokumente.

20 Pra, për sa kohë që vazhdojnë hetimet, ne nuk e dimë se çfarë
21 duhet të hetojmë. Prokuroria duhet të përmbushë mandatet e saj,
22 dhe në qoftë se kanë nevojë për ndihmën tonë, atëherë mund të na
23 thonë. Por në qoftë se hetimet vazhdojnë dhe ato hetime nuk lidhen
24 me ne, atëherë kjo pengon punën tonë.

25 Unë vë re që Prokuroria e ka dorëzuar gati një vit përpara

1 aktakuzën, dhe thonë që ende janë duke kryer hetime, dhe ky pohim
2 i tyre më duket i çuditshëm.

3 Për sa i përket mjedisit ku po kryhen -- ku po kryhet puna
4 jonë, dua, i nderuar Gjykatës, t'i kuptoni vështirësitë që kemi
5 ne. Ne si ekip i Mbrojtjes nuk kemi qenë në gjendje të udhëtojmë,
6 nuk kemi qenë në gjendje të takohemi me njëri-tjetrin për shkak të
7 KOVIDIT. Mund t'ju them që Departamenti i Shtetit amerikan
8 paralajmëron dhe thotë që njerëzit nuk duhet të udhëtojnë në
9 Kosovë dhe për rastin e Kosovës, thuhet shprehimisht që nuk duhet
10 të udhëtojnë në Kosovë. Nuk e di se çfarë thotë qeveria franceze
11 apo qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, por është e rëndësishme t'i
12 vë në dukje këto për të kuptuar dinamikën. Pra, është shumë e
13 rëndësishme për ne që të takohemi me njëri-tjetrin dhe të
14 diskutojmë dhe t'i kalojmë të gjitha këto çështje dhe
15 informacione.

16 Zotin Thaçi, klientin tim, nuk e kam takuar që prej kohës kur
17 është ngritur aktakuza kundër tij dhe e arrestuan. Ne nuk kemi
18 pasur mundësinë të ulemi me të dhe të shikojmë të gjitha
19 materialet faqe për faqe, të diskutojmë informacionin, deklaratat
20 e dëshmitarëve. Dhe kjo është për shkak të mjedisit, por edhe për
21 shkak të Prokurorisë.

22 Ne jemi përpjekur të bëjmë seanca në ZOOM me klientin, por ka
23 vështirësi edhe këtu, sepse çfarë mund të bësh me një
24 videokonferencë? Nuk mund të ndash dhe të diskutosh dokumente.
25 Pra, e dyta, ZOOM-i nuk është i sigurt, nuk është një platformë e

1 sigurt dhe ne nuk jemi -- nuk na pëlqen që të diskutojmë gjëra
2 sensitive, informacion sensitiv në ZOOM. Unë e di, vetë Prokuroria
3 për shembull, nuk e përdor ZOOM-in për shkak të çështjeve ose
4 shqetësimeve të sigurisë.

5 Pra, pika e fundit që desha të them në lidhje me këtë është
6 që derisa të jemi në gjendje që të lëvizim, të takohemi, të kemi
7 qasje në dokumente dhe të fillojmë një mjedis të përshtatshëm për
8 t'i bërë të gjitha këto punë, nuk mund të ecim përpara. Mund të
9 bëjmë ndonjë punë elementare, bazë, që është shqyrtimi i
10 informacionit që na ka dhënë Prokuroria, por, siç e thashë, ka
11 shumë kompleksitete puna e Mbrojtjes.

12 Ne sapo ta marrim informacionin do të punojmë me zell dhe do
13 të përpiqemi t'i plotësojmë, t'i përmbushim detyrat tona sapo të
14 na mundësohet një gjë e tillë. Faleminderit.

15 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk e di në qoftë
16 se mund të sqaroj diçka?

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Hooper, po, përpara se t'ia
18 jap fjalën z. Emmerson.

19 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] I nderuar
20 Gjykatës, ju donit -- dëshironit të dinit në qoftë se ne mund të
21 raportojmë lidhur me hetimet apo me vizitën në Kosovë. Në
22 përgjigje do të doja të thosha që ne planifikojmë ta bëjmë një gjë
23 të tillë diku nga prilli.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Z. Emmerson.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nga ana e

1 Mbrojtjes së Veselit neve e kemi kaluar procesin e shqyrtimit të
2 dokumentacionit dhe mundohemi që të kemi dhënë një version tonin,
3 le të themi, të asaj çfarë do të marrim si dosje paraprake nga
4 Prokuroria. Ndërkohë që sa i takon vlerësimeve që kanë të bëjnë me
5 atë pjesë të akuzave që kanë nevojë për hetime me përparësi, kjo
6 është në punë e sipër.

7 Pa diskutim që një ndër elementët sfidues të hetuesit, të
8 hetimit tonë, është që ne duhet që të kemi informacion, pra, së
9 pari do të duhet d.m.th., që hetuesit të emërohen nga DHKS-ja si
10 hetues i skuadrave tona, dhe më pas të vijojnë punën e tyre.
11 Ndërkohë që në rastin tonë personi nuk është -- nuk e kam marrë,
12 le të themi, këtë miratim nga Dhomat e Specializuar, ndërkohë që
13 hetuesi i ekipit tonë është prekur nga KOVIDI javën që vjen[sipas
14 përkthimit]. Kjo është një shenjë e komplikimeve të cilat
15 shoqërohen me periudhën e KOVIDIT. Megjithatë shpresojmë që ai të
16 bëhet mirë në ditët në vijim dhe më pas do t'i jepen të gjithë
17 informacionet e nevojshme, dokumentet, përfshirë këtu edhe
18 produktin e punës që ne kemi prodhuar si rezultat i shqyrtimit të
19 dokumentacionit nga nxjerrjet e ZPS-së. Pra, përfshirë këtu
20 dokumentacionet dhe materialet që kemi në dispozicion, përfshirë
21 edhe ato materiale të cilat janë konfidenciale.

22 Deri në këtë pikë kemi arritur ne sa i takon hetimeve. Kemi
23 ende për të kaluar në fazën operative të përparësive, por
24 aktualisht, siç e thashë, fakti që hetuesi kryesor ka qenë i
25 pamundur, ka qenë i sëmurë, nuk kemi proceduar më tej me këtë

1 pistë.

2 Sa i takon çështjes tjetër, sa i takon alibisë apo masave
3 speciale hetimore, është shumë herët për t'iu përgjigjur kësaj
4 pyetjeje. Dhe mendoj që kështu do të mbetet pozicioni ynë deri në
5 momentin kur ne të kemi parë dosjen paragjyqësore të dorëzuar nga
6 ZPS-ja. Vetëm atëherë do të kemi mundësi që të japim një përgjigje
7 sa i takon alibisë, apo sa i takon pjesës së masave të posaçme
8 hetimore.

9 D.m.th., e kam thënë dhe më përpara që alibia gjithmonë është
10 një koncept sfidues, është i komplikuar në kontekstin e çështjes
11 aktuale më në veçanti, por në qoftë se do të ketë alibi për sa i
12 takon mbrojtjes së z. Veseli, sigurisht që do të shprehem në një
13 moment tjetër kur të kemi më shumë informacione. Siç e kam thënë
14 edhe herë të tjera, siç e thashë edhe pak më përpara, pra, pasi të
15 marrë dosjen e seancës -- dosjen paragjyqësore.

16 Së fundi, nuk e di se deri në çfarë pike e ka vendin kjo
17 çështje në rendin e ditës së sotme, por do të doja që t'i
18 referohesha kërkesës së kohëve të fundit për masa mbrojtjeje nga
19 Prokuroria, të cilat janë identifikuar si goxha me përparësi në
20 agjendën e tij.

21 Prokuroria ka bërë kërkesën që deklaratat e mëparshme të
22 dëshmitarëve të caktuar, pra, deklaratat paraprake që ata kanë
23 bërë ose përpara vetë ZPS-së, ose organeve të tjera, ose palëve të
24 tjera, pra, duhet që të mbahen nga Mbrojtja, të mos i jepen
25 Mbrojtjes. Dhe po ashtu është thënë që Trupi Gjykses të mund të

1 vijoje me kundërpyetje në emër të Mbrojtjes.

2 Nuk e kam parë asnjëherë një përvojë të tillë, është e
3 paprecedentë si kërkesë. D.m.th., nocioni që mund të ketë
4 deklarata dëshmitarësh që nuk janë konsistente, dhe këto deklarata
5 nuk duhet t'i jepen Mbrojtjes në mënyrë që Mbrojtja të bëjë punën
6 e saj shqyrtuese, ose për të parë gjithashtu edhe deklaratat --
7 krahasimet me deklaratat e tjera të mëparshme për pikat e
8 përbashkëta apo jo, ne e shohim këtë si një derogim shumë të
9 jashtëzakonshëm, jo vetëm mbështetur në detyrimin për nxjerrjen,
10 por gjithashtu edhe mbi detyrimin e procesit gjyqësor të rregullt.

11 Kështu që ne duhet që të bëjmë kundërpyetje të dëshmitarëve
12 jo me sy mbyllur, por mbështetur në faktet dhe mbështetur në
13 dokumentet që kemi në dispozicion. Kështu që mua personalisht më
14 duket e jashtëzakonshme që Prokuroria të bëjë një sugjerim të
15 tillë, dhe pa diskutim që nuk e vlerëson, le të themi, rëndësinë e
16 madhe të tërësisë së aplikimit të vet.

17 Siç jua kemi thënë edhe më përpara, ne sigurisht që kemi një
18 përgjigje në lidhje me këtë. Megjithatë, dua që ta them qartë për
19 procesverbalin. Zgjidhja e duhur në qoftë se ZPS-ja nuk mund të
20 realizojë thirrjen e qartë, le të themi, të dëshmitarit, dhe në
21 qoftë se nuk i jep -- nuk nxjerr informacionin që ka të bëjë mbi
22 një dëshmitar të tillë, atëherë më vjen keq, po ZPS-ja duhet të
23 heqë dorë nga një dëshmitar i tillë, d.m.th., është e pamundur që
24 të vijohet në këtë mënyrë.

25 Pra, mendoj që ky është një moment shumë i rëndësishëm sa i

1 takon nxjerrjes, sepse aplikimi, kërkesa është e jashtëzakonshme
2 dhe tregon një mungesë të madhe kuptimi nga ZPS-ja të rëndësisë së
3 procesit të rregullt ligjor. Dhe me kalimin e kohës apo
4 gradualisht ne shpresojmë, i nderuar Gjykatës, që ju të mos
5 vendosni pro kësaj kërkesë. Në të kundërt do të ishte shumë
6 zhgënjyese për ne në qoftë se do të bënit një gjë të tillë, do ta
7 pranoni kërkesën e Prokurorisë.

8 Pra, nuk e dimë sesi mund të bëhet një hetim kur ka deklarata
9 që janë bërë më përpara të cilat u referohen personave, vendeve,
10 objekteve. Dhe kjo është puna jonë. Puna jonë është që të marrim
11 deklarata të tilla, të kemi një vështrim të përgjithshëm të
12 situatës. Pra, ne kemi një punë për të bërë këtu, dhe vlerësimi
13 tërësisht i drejtësisë dhe i procesit të rregullt ligjor është
14 absolutisht i qartë përmes kësaj kërkesë të Prokurorisë.

15 Do ju kërkonim, i nderuar Gjykatës, që të kishim mundësi që
16 të fillonim procesin e hetimit sa më shpejt të jetë e mundur.
17 Sigurisht që këtë gjë nuk mund përfundojmë pa marrë dosjen
18 paragjyqësore, të na dorëzohet nga ZPS-ja. Pra, hetuesit
19 aktualisht janë të ekspozuar, janë të prekur nga KOVIDI --
20 megjithatë shpresojmë që ta marrë veten gjatë dy, tre javëve të
21 ardhshme, dhe në këtë pikë do të vazhdojmë me procesin e
22 furnizimit të informacionit konfidencial edhe punës, apo
23 dokumenteve të cilat ne kemi përpunuar deri tani.

24 Megjithatë, këto janë hapat e parë të hetimit, dhe sigurisht
25 që duket që ZPS-ja e mendon si jo të rëndësishme për neve për të

1 parë deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve, apo dokumente të
2 tjera të cilat janë të rëndësishme për ne dhe të cilat janë në
3 përputhje me procesin e rregullit ligjor.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Young.

6 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kemi asgjë për
7 të thënë, i nderuar Gjykatës, sa i takon alibisë apo sa i takon
8 çështjes tjetër.

9 Sa i takon aftësisë tonë për të filluar hetimin, do të doja
10 të thosha dhe të shprehesha që në teori një pjesë e hetimeve mund
11 të fillojnë në prill. Megjithatë, procesi është ngadalësuar për
12 arsye që shkojnë përtej fuqisë tonë. Për shembull, hetimet për
13 mbrojtjen tonë mund të pengohen.

14 Ndërkohë, sa i takon redaktimeve për aktpadinë, dhe një
15 tjetër -- arsye tjetër është njëlloj vagullsie e përgjithshme e të
16 gjithë aktakuzës që e bën në tërësi aktakuzën të vështirë që të
17 çojë në hetime të caktuara, pavarësisht që faqet e aktakuzës janë
18 voluminoze, bëhet fjalë për mbi 600 faqe të saj. Dhe, nga ana
19 tjetër, do të doja të thosha që për shkak të pandemisë globale do
20 të kemi një hap më të ngadaltë të hetimeve, veçanërisht situata në
21 Kosovë.

22 Kosova është prekur si pjesë të tjera të botës, por nga ana
23 tjetër, fatkeqësisht për Kosovën nuk ka një plan për vaksinimin e
24 vendit, ndërkohë që Kosova është i vetmi vend në Evropë që deri më
25 sot nuk ka marrë asnjë vaksinë. Dhe ndërkohë -- të paktën deri dy

1 ditë më përpara, është raportuar nga burime të besueshme që nuk ka
2 arritur asnjë vaksinë në Kosovë. Kjo është një gjë e cila është
3 shumë e rëndësishme. Dhe do të doja t'ju kërkoja -- i nderuar
4 Gjykatës, që jemi të vendosur që të fillojmë sa më shpejt të jetë
5 e mundur, por ekzistojnë shumë arsye që na pengojnë në fillimin e
6 procesit hetimor.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

8 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Siç kemi
9 thënë në parashtrimet me shkrim, ne shpresojmë që të fillojmë me
10 hetimet në fund të prillit. Megjithatë, kjo varet nga vështirësi
11 të ndryshme të cilat janë sjellë në vëmendjen tuaj, i nderuar
12 Gjykatës, edhe nga kolegët e mi të Mbrojtjes të të akuzuarve të
13 tjerë. Pra, kemi pandeminë, kemi gjithashtu edhe përkthimet, kemi
14 dhe nxjerrjet e materialeve, i nderuar Gjykatës.

15 Sa i takon alibive dhe mundësive hetimore unike, ne nuk kemi
16 asgjë për të shtuar nga ajo çfarë kemi thënë më parë. E vetmja gjë
17 që mund të them për momentin, është që e rezervojmë pozicionin
18 tonë për t'u shprehur për këtë çështje më vonë.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Alagendra.

20 Zonja Prokurore, doni të thoni diçka lidhur mbi këtë çështje?
21 Ju lutem, vetëm lidhur me këtë çështje, jo çështje të tjera që
22 janë në diskutim, si për shembull, vendimi për masa të veçanta. Ju
23 lutem, vetëm për çështjen e hetimit të Mbrojtjes, në qoftë se keni
24 ndonjë gjë për të thënë.

25 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Në këtë rast do të doja të isha shumë

1 shkurt.

2 Të gjitha pikat të cilat janë nxjerrë nga Mbrojtja, jemi
3 dakord që janë arsye të qenësishme sepse Mbrojtja nuk e ka
4 përfunduar hetimin në këtë fazë. Megjithatë, do të doja të
5 theksoja që askush nuk u ka kërkuar që të përfundojnë hetimet deri
6 në këtë pikë, por ajo çfarë kërkohet është që hetimet të fillohen
7 në mënyrë normale domethënëse dhe Mbrojtja të jetë në një pozicion
8 që të vijojë normalisht me hetimet.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

10 Tani le të kalojmë te pjesa e argumenteve për çështje të
11 faktit dhe të ligjit.

12 Në konferencën e mëparshme, ZPS-ja na tha që është në një
13 fazë të avancuar brendapërbrenda për sa i takon përgatitjes së një
14 propozimi dhe dorëzimi të këtij propozimi për Mbrojtjen brenda një
15 periudhe të shkurtër.

16 Ju lutem, a mund të na thoni në qoftë se ZPS-ja ka dhënë
17 parashtrimet e veta për Mbrojtjen për çështje të ligjit dhe të
18 faktit; dhe do të doja t'i kërkoja palëve që të identifikojnë një
19 listë -- të cilët janë objekt diskutimi dhe një listë të çështjeve
20 të cilat janë përtej diskutimit, pra, nuk kanë nevojë të
21 diskutohen.

22 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Siç e kemi thënë në parashtrimin
23 tonë, ZPS-ja ka parashtruar dhe i ka dhënë Mbrojtjes dokumentet
24 përkatëse më datë 17 mars. Ne parashikojmë që të jemi në gjendje
25 që të informojmë Gjykatën për sa i takon pikave të marrëveshjes në

1 momentin kur të kemi rënë dakord me Mbrojtjen. Pra, kemi afatin
2 kohor më 9 prill, ndërkohë që e kuptojmë gjithashtu dhe
3 shqetësimin e Mbrojtjes së Krasniqit që po realizojnë procesin e
4 përkthimit dhe që mund të ketë ndikim mbi afatin kohor që ne kemi
5 rënë dakord paraprakisht. Kështu që do të doja që t'i drejtohesha
6 Mbrojtjes për të dhënë një parashikim të tyre se kur mund të jenë
7 në gjendje për të dhënë një afat për Dhomën.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Hooper.

10 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] 31 fjalë [sipas
11 përkthimit], pra, të parashtresave të kërkuara, ose pikat për të
12 cilat ne kemi rënë dakord. Pra, siç e tha Prokuroria, d.m.th.,
13 pritej që këto dokumente të mund të jepeshin më datë 9 prill. Po
14 të kishte thënë më datë 1 prill, do të mendoja që ishte -- po
15 bënte shaka. Por do të doja të thosha, a është realiste? A është e
16 mundur që 31 faqe pra, të mund të depozitohen, të mund të
17 parashtrohen më datë 17 mars, dhe duke pasur parasysh kushtet në
18 të cilat ne jemi, ne të biem dakord në mënyrë detyruese për disa
19 javë? Pra, në mënyrë realiste, a mund të pritet një gjë e tillë
20 nga ne?

21 Në qoftë se ata kanë nevojë, pra, Prokuroria ka nevojë për
22 njëlloj, le të themi, kohe realiste, dhe unë mund të thosha që kjo
23 kohë realiste mund të ishte diku nga shtatori i këtij viti.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

25 Z. Emerson.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Absolutisht që
2 ky është pozicioni edhe i yni, pra, pozicioni i Mbrojtjes. Më
3 lejoni të them që e kam parë dokumentacionin. Është goxha i
4 vagullt, sipërfaqësor, i hartuar në mënyrë sipërfaqësore, dhe më
5 duhet të them që çdo -- d.m.th., është e pamundur që të japim një
6 datë përpara sesa të marrim dosjen paragjyqësore.

7 Dhe për këtë arsye, do të doja të theksoja dhe njëherë
8 nevojën shumë të madhe tonën për të marrë dosjen paragjyqësore,
9 dhe do të doja të theksoja dhe njëherë që kjo dosje është
10 absolutisht jetike për ne. Pra, neve mendojmë që, le të themi,
11 dosjen paragjyqësore ta marrim shumë herë më përpara sesa
12 shtatori, diku nga vera, dhe ZPS-ja të bëjë punën e vet.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. Young.

15 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Z. Gjykatës,
16 aktualisht, pa diskutim që ne po shqyrtojmë dokumentacionin që na
17 ka dhënë, na ka vënë në dispozicion Prokuroria.

18 Pavarësisht respektit nga Prokuroria, propozimi dhe afatet
19 kohore që jepen nga ZPS-ja janë tërësisht jorealiste. D.m.th., nuk
20 është serioze, nuk është e besueshme ky afat kohor, kështu që jam
21 plotësisht dakord me atë çfarë u tha nga z. Hooper dhe nga z.
22 Emmerson.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

24 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë do t'ju
25 dërgoj parashtrimet me shkrim.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Alagenda.

2 Zonja Prokurore, ndonjë gjë për të shtuar shumë shkurtimisht?

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, do të doja të
4 thosha që në qoftë se Mbrojtja mendon që faktet të jenë të
5 diskutueshme, mjafton që të thonë që nuk janë dakord me faktet e
6 propozuara. Nuk mendoj se është çështje kaq komplekse për t'u
7 trajtuar.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

9 Tani, le të kalojmë te kalendari procedural i lidhur me
10 kërkesat paraprake.

11 Mbrojtja ka depozituar 11 kërkesa paraprake. Në një vendim të
12 mëparshëm, unë thashë apo kam përcaktuar datën 1 prill 2021, si
13 data që ZPS-ja t'i përgjigjej këtyre kërkesave. Sa i takon
14 parashtimeve të bëra për Konferencën e Gjendjes Gjyqësore, ZPS-ja
15 tha që -- kërkoj pra, që të mund të shtyhej ky afat kohor më 23
16 prill 2021.

17 Vërej po ashtu se në parashtimet për Konferencën e Gjendjes
18 së Çështjes, Mbrojtja e Krasniqit tregoi ndër të tjera numrin dhe
19 kompleksitetin e kërkesave paraprake, dhe në qoftë se ZPS-ja
20 kërkon shtyrjen e arsyeshme të kohës për këtë përgjigje, Mbrojtja
21 e Krasniqit nuk e kundërshton këtë gjë.

22 Duke pasur parasysh kërkesën për shtrirje kohore, për më
23 shumë kohë, do të doja që të kërkoja nga Mbrojtja se çfarë
24 mendimesh kanë dhe në qoftë se duan që të kërkojnë shtyrje kohe sa
25 i takon kërkesave.

1 Le të fillojmë së pari me Prokurorinë. Zonja Prokurore.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kam shumë për
3 të shtuar lidhur me këtë çështje. Neve po kërkojmë një shtyrje
4 deri më datë 23 prill, duke pasur parasysh volumin e kërkesave.
5 Dhe mendoj që ka arsye të qenësishme për të kërkuar një shtyrje të
6 tillë modeste.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.

8 Z. Hooper.

9 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Faleminderit, i
10 nderuar Gjykatës.

11 Jemi dakord me konstatimet e Mbrojtjes së z. Krasniqi. Dhe
12 sigurisht varet nga përgjigjet që ne do të marrim, por duke pasur
13 parasysh që Mbrojtjet në përgjithësi me çfarë kuptoj, pra, kanë
14 ndërmend që të fillojnë misionet e tyre në Kosovë diku nga prilli,
15 pavarësisht vështirësive, unë do të kërkoja që të na jepeshin tre
16 javë, neve pra, Mbrojtjes, për t'iu përgjigjur kërkesës së
17 Prokurorisë, dhe kjo pak a shumë koïncidon me datën 14 maj.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Hooper.

19 Z. Emmerson.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe unë kam të
21 njëjtin qëndrim. Nuk kam ndonjë kundërshtim për kërkesën për
22 shtyrjen e afatit nga Prokuroria. Ndërkohë që sa i takon afatit
23 tonë, unë propozoj 15 majin.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Emmerson.

25 Z. Young.

1 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe unë kam të
2 njëjtën përgjigje, i nderuar Gjykatës.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Young.
4 Znj. Alagendra.

5 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Tre javë
6 është mjaftueshëm mendoj, z. Gjykatës, që të përgjigjem. Këtë afat
7 kohor kërkoj dhe unë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Unë do të nxjerr
9 një urdhër me gojë në fund të kësaj seance.

10 Së fundi, unë do të doja që t'i kërkoja palëve që të më
11 jepnin përshtypjet e tyre sa i takon një date të përshtatshme për
12 Konferencën tjetër të Gjendjes Gjyqësore.

13 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Do të jemi të disponueshëm në një
14 moment që të jetë i përshtatshëm për Gjykatësin, në çdo moment të
15 muajit prill. Faleminderit.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, zonja Prokurore.
17 Z. Hooper.

18 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Unë do të
19 parashtroja se nuk është e nevojshme që të mbajmë një Konferencë
20 për Ecurinë e Çështjes gjatë muajit prill. Një ditë pas datës
21 përfundimtare të përgjigjes, 15 majit, ose rreth kësaj date, do të
22 ishte më e përshtatshme, sepse këto konferenca, siç e dini edhe
23 ju, kërkojnë shumë kohë nga ana jonë. Ne do të kemi gjithashtu dhe
24 hetimet mbase gjatë muajit prill, të cilat do të na duhet që t'i
25 bëjmë.

1 Gjithsesi nëse do të ketë një Konferencë për Ecurinë e
2 Çështjes dhe nëse z. Thaçi dëshiron që të mos marrë pjesë, do të -
3 - d.m.th., besoj se kjo do të ishte e pranueshme për Gjykatën.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

5 Z. Emerson.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Do të mendoja
7 pas datës 15 maj do të ishte më e mundshme.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Young.

10 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe ne jemi dakord
11 për mesin e muajit maj.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

13 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Edhe unë mbaj
14 të njëjtin qëndrim. Pas 15 majit do të ishte e përshtatshme.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

16 Do të jap një vendim përmes një urdhri për caktimin e datës.

17 Ftoj palët që të bëjnë parashtime me shkrim lidhur me
18 çështje që duan të ngrenë në Konferencën e ardhshme për Çështjen.

19 Në këtë moment dëshiroj që të pyes palët nëse duan të ngrenë
20 çështje të tjera, por u them atë që të na paralajmërojnë nëse do
21 të ketë nevojë për marrjen e masave për t'u mbrojtur informacioni
22 konfidencial.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Nuk kemi gjë, i nderuar Gjykatës.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. Hooper.

1 Z. HOOPER: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Vetëm një çështje.
2 A keni ndonjë ide se kur kolegët tuaj të Dhomës së Apelit do të
3 marrin vendim lidhur me lirimin e përkohshëm? Sepse sigurisht
4 ndikon edhe te gjërat që ne po bëjmë, e të tjera, e të tjera. Na
5 duhen përgjigjet e të ngjashme. Do të na duhen shtatë ditë për t'i
6 ripërtërirë kërkesat tona. Faleminderit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk kam asnjë informacion, por
8 me siguri do t'ju duhet që t'i drejtoheni vetë asaj Dhome. Unë
9 vetë nuk mund t'ju jap përgjigje.

10 Z. Emerson.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. Z. Young.

13 Z. YOUNG: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam asgjë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Alagendra.

15 ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Asgjë për të
16 shtuar.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit atëherë.

18 I falënderoj palët për parashtrimet e tyre. Do të bëjmë një
19 pushim këtu dhe do të rifillojmë seancën pas 30 minutash, gjatë të
20 -- pas të cilave do të jap disa urdhra gojarisht. Mbyllet seanca
21 këtu për të rifilluar më vonë.

22 --- Pauza fillon në orën 13.04

23 --- Rifillon në orën 13.40

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pasi dëgjova palët, do të jap
25 tani gojarisht urdhrin e parë.

1 I jap urdhër ZPS-së që t'i japë Mbrojtjes materialet e
2 mbetura që i janë treguar secilit prej të akuzuarve gjatë
3 intervistave përkatëse përpara Konferencës së ardhshme për Ecurinë
4 e Çështjes.

5 Ky ishte urdhri i parë gojarisht.

6 Pasi dëgjova palët, do të jap një urdhër të dytë gojarisht
7 mbi kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit dhe të Krasniqit për -- ku ata
8 kërkojnë ZPS-ja të japë gjitha incizimet audiovizive për të gjitha
9 intervistat e dëshmitarëve dhe të akuzuarve.

10 Vërej se kuadri ligjor i Dhomave të Specializuara nuk vendos
11 mbi Prokurorinë detyrimin specifik për të vendosur në dispozicion
12 incizimet audiovizive lidhur me intervistat e dëshmitarëve dhe të
13 akuzuarve. Në këto rrethana, si rregull e përgjithshme, aty ku
14 incizimet audiovizive të intervistave me dëshmitarë dhe të akuzuar
15 janë zbardhur në transkriptime, dhe këto transkriptime janë
16 vendosur në dispozicion, parimisht incizimet audiovizive nuk është
17 nevoja që të vendosen në dispozicion, duke qenë se transkriptimet
18 dhe incizime audiovizive përmbajnë të njëjtat fjalë që janë dhe në
19 incizim.

20 Por, nga ana tjetër, mungesa e një dispozite të tillë ligjore
21 lidhur me nxjerrjen e incizimeve audiovizive nuk e përjashton
22 medoemos mundësinë që ky informacion të vendoset në dispozicion
23 nga ZPS-ja nëse del qartë që incizimet audiovizive janë me rëndësi
24 materiale për përgatitjes e Mbrojtjes, sipas kuptimit të rregullës
25 102(3) të Rregullores, ku mbulohen të gjitha llojet e materialeve,

1 në varësi të kufizimeve që vendosin rregullat 107 dhe 108.

2 Në rastin në fjalë, argumenti i Mbrojtjes lidhur me nevojën
3 për verifikimin e saktësisë së transkriptimeve, është pa thënë
4 diçka më shumë, pra, është i pamjaftueshëm për të justifikuar
5 nxjerrjen shtesë të incizimeve audiovizive, duke qenë se ky
6 verifikim mund të kryhet në bazë të transkriptimeve të vendosura
7 në dispozicion që janë në gjuhën shqipe dhe angleze.

8 Gjithashtu, argumenti i Mbrojtjes lidhur me nevojën për një
9 vlerësim të plotë të dëshmitarit është i pamjaftueshëm -- nuk
10 është i bazuar mjaftueshëm duke qenë se mbetet si një argument
11 hipotetik dhe i përgjithshëm. Në veçanti, Mbrojtja nuk arrin që të
12 mbështesë me baza përse mbështetja të transkriptimet, në dallim
13 nga incizimet audiovizive, nuk i jep mundësi Mbrojtjes që të
14 vlerësojë dëshminë e dhënë nga dëshmitarët në mënyrë të plotë.

15 Në këto rrethana, pasi -- duke qenë se nuk vërtetohet
16 materialiteti i incizimeve audiovizive, unë e rrëzoj poshtë
17 kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit dhe të Krasniqit për vendosjen në
18 dispozicion të incizimeve audiovizive krahas transkriptimeve të
19 dëshmitarëve -- të intervistave të dëshmitarëve dhe të akuzuarve.

20 Tani do të kaloj lidhur me mekanizmin -- kjo ka të bëjë edhe
21 me mekanizmin e vendosjes në dispozicion në përputhje me Vendimin
22 Kornizë për nxjerrjen e materialeve.

23 Këtu mbyllet urdhri i dytë.

24 Do të kaloj tani tek urdhri i tretë gojarisht.

25 I jap urdhër Zyrës Administrative që të riklasifikojë

1 parashtrimin numër 236 [sipas përkthimit] --

2 I jap urdhër Mbrojtjes së Thaçit për të parashtruar një
3 version të redaktuar publik të parashtrimit numër 236 brenda datës
4 31 mars 2021. Në veçanti Mbrojtja e Thaçit duhet të redaktojë
5 përmendjen e numrave specifikë ERN në poshtëshënimet, shënime
6 poshtë faqes pra, 11, 12, 13 dhe 14 që kanë lidhje me dëshmitarët
7 për të cilët janë miratuar masat mbrojtëse.

8 I jap urdhër dhe Mbrojtjes së Krasniqit për të parashtruar
9 një version të redaktuar publik të parashtrimit numër 228 brenda
10 datës 31 mars 2021.

11 Këtu mbyllet urdhri i tretë.

12 Pas parashtrimeve që bënë palët lidhur me Konferencën për
13 Ecurinë e Çështjes, unë mbaj parasysh se të gjitha çështjet dhe
14 kërkesat e tjera të përfshira në parashtrimet 213 dhe 228 janë
15 zgjidhur. Rikujtoj këtu dhe kërkesën e Mbrojtjes së Veselit për
16 një -- që dosja paraprake e ZPS-së të depozitohet në prill
17 2020[sipas përkthimit] dhe kjo është rrëzuar në vendimin tim, siç
18 e kemi thënë më përpara.

19 Pasi dëgjova palët për çështjen, unë jap këtë urdhër.

20 I jap urdhër Prokurorisë që t'i vendosë në dispozicion
21 Mbrojtjes një njoftim të hollësishëm të provave që janë objekt i
22 rregullës 102(3) të Rregullores brenda datës 25 qershor 2021; i
23 jap urdhër Mbrojtjes që t'i bëjë të ditur ZPS-së brenda datës 20
24 gusht 2021, ose në një datë edhe më të hershme, se cilat materiale
25 në mes atyre që janë listuar në njoftimin e hollësishëm duan që të

1 kenë në dispozicion për të përdorur përmes nxjerrjes apo përmes
2 konsultimit; gjithashtu, ZPS-në e urdhëroj që brenda datës 10
3 shtator 2021, ose brenda tre javësh nga dhënia e indikacionit nga
4 Mbrojtja, cilado qoftë kjo më e hershme, t'i vendosë në
5 dispozicion Mbrojtjes, apo t'i nxjerrë Mbrojtjes materialet
6 përkatëse të cilat nuk kërkojnë redaktime, dhe të parashtrojë
7 kërkesë për masa mbrojtëse nëse do të ketë të tilla lidhur me
8 materialet që kërkon Mbrojtja, dhe t'ia vendosë në dispozicion
9 këto sa më shpejt që të jetë e mundur.

10 Këtu mbyllet urdhri im i katërt.

11 Tani, do të jap urdhrin e pestë gojarisht lidhur me afatet
12 për përgjigjet dhe replikimet mbi mocionet paraprahe, të cilat i
13 ka parashtuar Mbrojtja.

14 Pasi dëgjova palët mbi këtë çështje, në përputhje me
15 rregullën 95(a), i jap urdhër ZPS-së që të japë përgjigjet për
16 mocionet paraprahe të parashtuara nga Mbrojtja brenda datës 23
17 prill 2021; dhe Mbrojtjes që të bëjë replikimet përkatëse për
18 përgjigjet e ZPS-së brenda datës 14 maj 2021.

19 Këtu mbyllet urdhri i fundit.

20 Këtu mbyllet edhe seanca për sot. Falënderoj palët.
21 Falënderoj, në veçanti, avokatët të cilët janë lidhur me ne nga
22 një zonë tjetër kohore.

23 Shikoj që z. Emmerson dëshiron të thotë diçka.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Lidhur me datën
25 e dosjes paraprahe dhe vendimit të të nderuarit Gjykatës për

1 paragrafin 23 në dokumentin 218.

2 Ajo që ju keni vendosur në këtë paragraf është se vendimi i
3 kategorizimit ka të bëjë me atë, që ju thatë, që ju nuk shikoni
4 arsye për t'i dhënë urdhër ZPS-së që ta parashtrojë dosjen
5 paraprake në prill të vitit 2021, duke pasur parasysh vendimin e
6 kategorizimit. Sigurisht, kjo e lë të hapur çështjes se në ç' datë
7 Prokuroria do të vendosë në dispozicion dosjen paraprake dhe ju e
8 keni mbështetur parashtrimin e Prokurorisë që kjo datë duhet të
9 lidhet me afatin tremujor me fillimin e gjykimit.

10 Prandaj, duke pasur parasysh këtë, unë e ripërtërij kërkesën
11 time që -- për këtë kohë.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Emmerson. E
13 mbajta shënim.

14 Falënderoj palët dhe Zyrën Administrative. Falënderoj edhe
15 përkthyesit, stenografët, teknikët dhe personelin e sigurisë.

16 Këtu mbyllet seanca për sot. Faleminderit.

17 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes mbyllet në orën 13.50

18

19

20

21

22

23

24

25